



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 28

2003

Prill

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9031 datë 20.3.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Budapestit për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave, për qëllime të procedurës së patentave	885
Ligj nr.9032 datë 20.3.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën ndërkombëtare për vijat e ngarkesës” 1966.....	895
Ligj nr.9033 datë 20.3.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Nicës për klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve, për qëllimet e regjistrimit të markave.....	908

L I G J
Nr.9031, datë 20.3.2003

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË TRAKTATIN E BUDAPESTIT PËR
NJOHJEN NDËRKOMBËTARE TË DEPOZITIMIT TË MIKROORGANIZMAVE, PËR
QËLLIME TË PROCEDURËS SË PATENTAVE**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Traktatin e Budapestit për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave, për qëllime të procedurës së patentave.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3776, datë 16.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

TRAKTATI

**I BUDAPESTIT PËR NJOHJEN NDËRKOMBËTARE TË DEPOZITIMIT TË
MIKROORGANIZMAVE, PËR QËLLIME TË PROCEDURËS SË PATENTAVE
BËRË NË BUDAPEST, MË 28 PRILL 1977 DHE NDRYSHUAR MË 26 SHTATOR 1980**

DISPOZITA FILLESTARE

Neni 1

Themelimi i një bashkimi

Shtetet Palë në këtë Traktat (këtej e tutje quajtur “Shtetet Kontraktuese”) përbëjnë një bashkim për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave për qëllimet e procedurës së patentave.

Neni 2

Përcaktimet

Për qëllimet e këtij Traktati dhe rregulloreve:

i) Referencat për një “patentë” interpretohen si referenca në patentat e shpikjeve, certifikatat e shpikësve, certifikatat e përdorimit, modeleve të përdorimit, patentat dhe certifikatat shtesë, certifikatat e shpikësve shtesë dhe certifikatat e përdorimit shtesë.

ii) “Depozitim i një mikroorganizmi” do të thotë, sipas përmbajtjes në të cilën shfaqen këto fjalë, aktet e mëposhtme të përmbushura në pajtim me këtë Traktat dhe rregulloret; transferimi i një mikroorganizmi në një autoritet depozitimi ndërkombëtar, i cili e merr dhe e pranon atë ose magazinimi i të tillë mikroorganizmave nga një autoritet depozitimi ndërkombëtar, ose së bashku transferimi dhe magazinimi të përmendur.

iii) “Procedurë patente” do të thotë çdo procedurë administrative dhe procedurale lidhur me një aplikim për patentë ose patentë.

iv) “Publikim për qëllimet e procedurës për patentë” do të thotë publikimi zyrtar ose paraqitja zyrtare e hapur për inspektim publik të aplikimit për një patentë ose një patentë.

(v) “Organizatë ndërqeveritare e pronësisë industriale” do të thotë një organizatë që ka depozituar një deklaram sipas nenit 9 (1).

vi) “Zyrë e pronësisë industriale” do të thotë një autoritet i një Shteti Kontraktues ose një organizatë ndërqeveritare e pronësisë industriale kompetente për lëshimin e patentave.

vii) “Institucion depozitimi” do të thotë një institucion, i cili siguron me dëftesë pranimin dhe magazinimin e mikroorganizmave dhe furnizimin me mostra.

viii) “Autoritet ndërkombëtar depozitimi” do të thotë një institucion depozitimi, i cili ka fituar statusin e autoritetit ndërkombëtar të depozitimit, siç sigurohet në nenin 7.

ix) “Depozitues” do të thotë një person fizik ose juridik, që përcjell një mikroorganizëm tek një autoritet ndërkombëtar depozitimi, i cili e merr dhe e pranon atë dhe çdo trashëgimtar me të drejtë pronësie të personit fizik ose juridik në fjalë.

x) “Bashkim” do të thotë bashkim sipas nenit 1.

xi) “Asamble” do të thotë asamble sipas nenit 10.

xii) “Organizatë” do të thotë Organizatë Botërore e Pronësisë Intelektuale.

xiii) “Byro Ndërkombëtare” do të thotë Byroja Ndërkombëtare e Organizatës dhe për sa kohë ekziston, Byroja Ndërkombëtare e Bashkuar për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (BIRPI).

xiv) “Drejtor i Përgjithshëm” do të thotë Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës.

xv) “Rregullore” do të thotë rregulloret sipas nenit 12.

KAPITULLI I DISPOZITAT KRYESORE

Neni 3

Njohja dhe kryerja e depozitimit të mikroorganizmave

1. a) Shtetet Kontraktuese, të cilat lejojnë ose kërkojnë depozitimin e mikro-organizmave për qëllimet e procedurës së patentës do të njohin, për këto qëllime, depozitimin e një mikroorganizmi pranë çdo autoriteti ndërkombëtar depozitimi. Kjo njohje do të përfshijë pranimin e faktit dhe datës së depozitimit, siç tregohet nga autoriteti ndërkombëtar i depozitimit, si dhe pranimin e faktit se çfarë është siguruar si një mostër, është një mostër e mikroorganizmit të depozituar.

b) Çdo Shtet Kontraktues mund të kërkojë një kopje të dëftesës së depozitimit përmendur në nënparagrafin (a), lëshuar nga autoriteti ndërkombëtar i depozitimit.

2. Përsa i përket çështjeve rregulluar në këtë Traktat dhe rregulloreve përkatëse, asnjë Shtet Kontraktues nuk mund të kërkojë pajtimin me kërkesa ndryshe ose shtesë nga ato të cilat janë siguruar në këtë Traktat dhe në rregulloret.

Neni 4

Depozitimi i ri

1. a) Aty ku autoriteti ndërkombëtar i depozitimit nuk mund të sigurojë mostrat e depozituara të mikroorganizmit për çdo arsye, veçanërisht:

i) aty ku ky mikroorganizëm nuk është gjatë i qëndrueshëm ose

ii) aty ku sigurimi i mostrave do të kërkonte që ato të dërgoheshin jashtë dhe dërgimi ose marrja e mostrave jashtë është i ndaluar nga kufizimet në eksport ose import,

ky autoritet do të njoftojë menjëherë, pasi është njohur me paaftësinë e tij për t'i siguruar këto mostra, depozituesin për këtë paaftësi, duke treguar edhe shkakun dhe depozituesi i nënshtrohet paragrafit (2) dhe, siç është siguruar në këtë paragraf, ka të drejtën që të bëjë një depozitim të ri të mikroorganizmit, i cili është depozituar në origjinal.

b) Depozitimi i ri do të bëhet pranë autoritetit ndërkombëtar të depozitimit pranë të cilit është bërë depozitimi origjinal, me kusht që:

i) Ky të bëhet pranë tjetër autoriteti ndërkombëtar të depozitimit aty ku institucioni me të cilin është bërë depozitimi origjinal ka humbur statusin e autoritetit ndërkombëtar të depozitimit ose krejtësisht, ose në lidhje me këtë lloj mikroorganizmi, të cilit i përket mikroorganizmi i depozituar, ose

aty ku autoriteti ndërkombëtar i depozitimit, pranë të cilit është bërë depozitimi origjinal ndërpret përkohësisht ose përfundimisht, shfaqjen e funksioneve të tij në lidhje me mikroorganizmat e depozituar.

ii) Ky mund të bëhet me tjetër autoritet ndërkombëtar të depozitimit në rastin e përmendur në nënparagrafin (a)(ii).

c) Çdo depozitim i ri do të shoqërohet nga një deklaratë nënshkruar nga depozituesi duke dëshmuar që mikroorganizmi i sapo depozituar është i njëjtë me atë origjinal të depozituar. Në qoftë se dëshmia e depozituesit kontestohet, barra për dëshminë do të jetë sipas ligjeve në fuqi.

d) Varësisht nënparagrafëve (a), (c) dhe (e), depozita e re trajtohet sikur ajo të jetë bërë në datën në të cilën është bërë depozita origjinale, ku të gjitha deklaratat paraardhëse, në lidhje me qëndrueshmërinë e mikroorganizmit të depozituar në mënyrë origjinale, treguan që mikroorganizmi ishte i qëndrueshëm dhe se depozita e re ishte bërë brenda tre muajve pas datës në të cilën depozituesi mori njoftimin përmendur në nënparagrafin (a).

e) Aty ku aplikohet nënparagrafi (b)(i) dhe depozituesi nuk merr njoftimin përmendur në paragrafin (a), brenda gjashtë muajve pas datës në të cilën përfundimi, kufizimi ose ndërprerja, përmendur në nënparagrafin (b)(i), është publikuar nga Byroja Ndërkombëtare, tre muaj kohë limit, përmendur në nënparagrafin (d), do të numërohen nga data e publikimit të thënë.

2. E drejta përmendur në paragrafin (1)(a) nuk do të ekzistojë aty ku mikroorganizmi i depozituar ka qenë transferuar tek një tjetër autoritet ndërkombëtar depozitimi, për sa kohë që autoriteti është në një pozitë që të sigurojë mostrat e këtij mikroorganizmi.

Neni 5

Kufizimet e eksportit dhe importit

Secili Shtet Kontraktues pranon që është shumë e dëshirueshme që, në qoftë se shtrirja e eksportit ose importit në territorin e vendit të tij për këto lloj mikroorganizmash është i kufizuar, ky kufizim duhet zbatuar për mikroorganizmat e depozituar ose destinuar për depozitim, sipas këtij Traktati, vetëm aty ku kufizimi është i nevojshëm në pikëpamje të sigurisë kombëtare ose dëmtimit të shëndetit ose ambientit.

Neni 6

Statusi i autoritetit ndërkombëtar të depozitimit

1. Me qëllim për t'u kualifikuar për statusin e autoritetit ndërkombëtar të depozitimit, çdo institucion depozitimi duhet të jetë i vendosur në territorin e një Shteti Kontraktues dhe duhet të përfitojë nga garancia e siguruar nga ky shtet në kuptimin që ky institucion zbaton dhe do të vazhdojë të zbatojë kërkesat e specifikuara në paragrafin 2. Institucioni mund të sigurohet gjithashtu nga një organizatë ndërqeveritare e pronësisë industriale; në këtë rast, institucioni i depozitimit duhet të jetë vendosur në territorin e një shteti anëtar të organizatës së përmendur.

2. Institucioni i depozitimit, në kapacitetin e autoritetit ndërkombëtar të depozitimit, duhet:

- i) të ketë një ekzistencë të vazhdueshme;
- ii) të ketë stafin e nevojshëm dhe lehtësirat e nevojshme, ashtu siç përshkruhet në rregulloret për të kryer detyrat e tij shkencore dhe administrative sipas këtij Traktati;
- iii) të jetë i paanshëm dhe objektiv;
- iv) të jetë i disponueshëm për qëllime të depozitimit për çdo depozitues sipas të njëjtave kushte;
- v) të pranojë për depozitim çdo mikroorganizëm ose lloj të përcaktuar të mikroorganizmave, të kontrollojë qëndrueshmërinë e tyre dhe t'i depozitojë ato, ashtu siç përshkruhet në rregulloret;
- vi) të lëshojë një dëftesë për depozituesin dhe çdo deklaratë qëndrueshmërie të kërkuar, ashtu siç përshkruhet në rregulloret;
- vii) të zbatojë, përsa i përket mikroorganizmave të depozituar, kërkesën e ruajtjes së sekretit, ashtu siç përshkruhet në rregulloret;
- viii) të sigurojë mostrat e çdo mikroorganizmi të depozituar sipas kushteve dhe në konformitet në procedurat e përshkruara në rregulloret.

3. Rregulloret do të sigurojnë masat që do të merren:

i) aty ku një autoritet ndërkombëtar depozitimi shkëput përkohësisht ose përfundimisht, kryerjen e funksioneve të tij përsa i përket mikroorganizmave të depozituar ose refuzojë që të pranojë çdo lloj të mikroorganizmave, të cilat ai do t'i pranonte sipas garancisë së siguruar;

ii) në rastin e përfundimit ose kufizimit të statusit të autoritetit ndërkombëtar të një autoriteti ndërkombëtar të depozitimit.

Neni 7

Përfitimet e statusit të autoritetit ndërkombëtar të depozitimit

1. a) Një institucion depozitimi do të përfitojë statusin e autoritetit ndërkombëtar të depozitimit me anë të një komunikimi të shkruar adresuar Drejtorit të Përgjithshëm nga Shteti Kontraktues, në territorin e të cilit është vendosur institucioni i depozitimit dhe që përfshin një deklaratë garancie në kuptimin që institucioni i përmendur përmbush dhe do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e specifikuar në nenin 6(2). Statusi i përmendur mund të përfitohet gjithashtu me anë të një komunikimi të shkruar, adresuar Drejtorit të Përgjithshëm nga një organizatë ndërqeveritare e pronësisë industriale dhe që përfshin deklaratën e përmendur.

b) Komunikimi do të përmbajë gjithashtu informacion për institucionin e depozitimit, ashtu siç është kërkuar në rregulloret dhe mund të tregojë datën në të cilën do të ketë efekt statusi i autoritetit ndërkombëtar të depozitimit.

2. a) Në qoftë se Drejtori i Përgjithshëm gjen se komunikimi përfshin deklaratat e kërkuara dhe janë marrë të gjitha informacionet e kërkuara, komunikimi do të publikohet menjëherë nga Byroja Ndërkombëtare.

b) Statusi i autoritetit ndërkombëtar të depozitimit përfitohet në datën e publikimit të komunikimit ose, aty ku është shënuar data sipas paragrafit (1)(b) dhe kjo datë është më e vonshme se data e publikimit të komunikatës, do ta përfitojë në këtë datë.

3. Detajet e procedurës sipas paragrafëve 1 dhe 2 janë të siguruar në rregulloret.

Neni 8

Përfundimi dhe kufizimi i statusit të autoritetit ndërkombëtar të depozitimit

1. a) Çdo Shtet Kontraktues ose çdo organizatë ndërqeveritare e mbrojtjes së pronësisë industriale mund t'i kërkojë Asamblesë që të përfundojë ose të kufizojë për lloje të caktuara të mikroorganizmave, çdo status autoriteti ndërkombëtar të depozitimit, bazuar në atë, që kërkesat e specifikuar në nenin 6 nuk janë zbatuar ose nuk do të zbatohen më. Megjithatë, një kërkesë e tillë nuk mund të bëhet nga një Shtet Kontraktues ose organizatë ndërqeveritare e pronësisë industriale përsa i përket autoritetit ndërkombëtar të depozitimit, për të cilin është bërë deklarata përmendur në nenin 7(1)(a).

b) Përpara bërjes së kërkesës sipas nënparagrafit (a), Shteti Kontraktues ose organizata ndërqeveritare e pronësisë industriale do të njoftojë, përmes ndërmjetësisë së Drejtorit të Përgjithshëm, arsyet për kërkesën e propozuar Shtetit Kontraktues ose organizatës ndërqeveritare të pronësisë industriale, e cila ka bërë komunikimin përmendur në nenin 7 (1) kështu që ky shtet ose kjo organizatë, brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit të përmendur, mund të ndërmarrë veprime të përshtatshme për të shmangur nevojën e bërjes së kërkesës së propozuar.

c) Aty ku Asambleja gjen kërkesën të formuluar mirë ajo do të vendosë në përfundimin ose në kufizimin e llojeve të caktuara të mikroorganizmave, të statusit të autoritetit ndërkombëtar të depozitimit ose të autoritetit përmendur në nënparagrafin a. Vendimi i Asamblesë do të kërkojë që shumica e dy të tretave të votave të hedhura të jenë në favor të kërkesës.

2. a) Shteti Kontraktues ose organizata ndërqeveritare e pronësisë industriale që ka bërë deklaratën përmendur në nenin 7(1)(a), me anë të një komunikimi adresuar Drejtorit të Përgjithshëm, mund ta tërheqë deklaratën, ose në tërësi, ose përsa i përket vetëm llojeve të caktuara të mikroorganizmave dhe në çdo rast vepron kështu kur shkalla e garancive nuk është më e zbatueshme.

b) Ky komunikim do të përfshijë, nga data e siguruar në rregulloret, përfundimin e statusit të autoritetit ndërkombëtar të depozitimit aty ku ky ka të bëjë me komplet deklaratën ose një kufizim të njëjtë të këtij statusi aty ku ky ka të bëjë vetëm me lloje të caktuara të mikroorganizmave.

3. Detajet e procedurave sipas paragrafëve (1) dhe (2) janë siguruar në rregulloret.

Neni 9

Organizatat ndërqeveritare të pronësisë industriale

1. a) Çdo organizatë ndërqeveritare së cilës disa shtete i kanë besuar detyrën e dhënies të patentave rajonale dhe të së cilës të gjitha shtetet anëtare janë anëtare të Bashkimit Ndërkombëtar (të Parisit) për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale mund të depozitojë pranë Drejtorit të Përgjithshëm një deklaratë, me të cilën pranon detyrimin e njohjes siguruar në nenin 3(1)(a), detyrimin lidhur me kërkesat e përmendura në nenin 3(2) dhe të gjitha efektet e dispozitave të këtij Traktati dhe rregulloreve të zbatueshme për organizatat ndërqeveritare të pronësisë industriale. Në qoftë se depozitimi i deklaratës bëhet përpara hyrjes në fuqi të këtij Traktati sipas nenit 16(1), deklarata e përmendur në fjalinë e mëparshme do të bëhet efektive në datën e përmendur të hyrjes në fuqi. Në qoftë se depozitimi bëhet pas kësaj date të hyrjes në fuqi, deklarata e përmendur do të bëhet efektive tre muaj pas depozitimit, po qe se nuk është shënuar një datë e mëvonshme në deklaratë. Në rastin më të fundit, deklarata do të ketë efekt në këtë datë të shënuar.

b) Organizata e përmendur do të ketë të drejtën e siguruar në nenin 3(1)(b).

2. Aty ku çdo dispozitë e këtij Traktati, ose rregulloret, që prek organizatat ndërqeveritare të pronësisë industriale është rishikuar ose ndryshuar, çdo organizatë ndërqeveritare e pronësisë industriale mund të tërheqë deklaratën e saj të përmendur në paragrafin (1) me anë të një njoftimi adresuar Drejtorit të Përgjithshëm. Tërheqja do të ketë efekt:

i) aty ku njoftimi merret përpara datës në të cilën ka hyrë në fuqi, rishikuar apo ndryshuar në atë datë;

ii) aty ku njoftimi merret pas datës përmendur në pikën (i), në datën e shënuar në njoftim ose në mungesë të këtij shënimi, tre muaj pas datës në të cilën është marrë njoftimi.

3. Përveç rasteve përmendur në paragrafin (2), çdo organizatë ndërqeveritare e pronësisë industriale mund të tërheqë deklaratën e saj të përmendur në paragrafin (1)(a) me anë të një njoftimi adresuar Drejtorit të Përgjithshëm. Tërheqja do të ketë efekt dy vjet pas datës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm merr njoftimin. Asnjë njoftim, për tërheqje sipas këtij paragrafi, nuk pranohet gjatë periudhës së pesë vjetëve nga data në të cilën deklarata është zbatuar.

4. Tërheqja e përmendur në paragrafin (2) ose (3) nga një organizatë ndërqeveritare e pronësisë intelektuale, komunikimi i së cilës sipas nenit 7(1) ka sjellë përfitimin e statusit të autoritetit ndërkombëtar të depozitimit nga një institucion depozitimi do të përfshijë përfundimin e këtij statusi një vit pas datës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka marrë njoftimin e tërheqjes.

5. Çdo deklaratë përmendur në paragrafin (1)(a), njoftimi i tërheqjes përmendur në paragrafin (2) ose (3), garancitë e siguruar sipas nenit 6(1), fjalina e dytë, dhe të përfshirë në një deklaratë bërë sipas nenit 7(1)(a), kërkesë e bërë sipas nenit 8(1) dhe njoftim të tërheqjes përmendur në nenin 8(2) do të kërkojnë aprovimin paraprak e të shpejtë të organit drejtues më të lartë të organizatës ndërqeveritare të pronësisë industriale, anëtarë të së cilës janë të gjitha shtetet anëtare të organizatës së përmendur dhe në të cilën vendimet janë marrë nga përfaqësuesit zyrtarë të qeverive të këtyre shteteve.

KAPITULLI II

DISPOZITA ADMINISTRATIVE

Neni 10

Asambleja

1. a) Asambleja përbëhet nga Shtetet Kontraktuese.

b) Secili Shtet Kontraktues është i pranishëm me nga një anëtar, i cili mund të jetë asistuar nga delogatë të ndryshëm, këshilltarë dhe ekspertë.

c) Secila organizatë ndërqeveritare e pronësisë industriale është e pranishme nga vëzhgues të veçantë në mbledhjet e asamblesë dhe çdo komiteti dhe grupi pune të krijuar nga Asambleja.

d) Çdo shtet joanëtar i bashkimit, i cili është anëtar i Organizatës ose i Bashkimit Ndërkombëtar (të Parisit) për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe çdo organizatë ndërqeveritare të specializuar në fushën e patentave ose të një organizate ndërqeveritare të pronësisë industriale siç

përcaktohet në nenin 2(v) mund të jetë i pranishëm me anë të vëzhguesve në mbledhjet e Asamblesë dhe, në qoftë se Asambleja vendos, në mbledhjet e çdo komiteti ose grupi pune krijuar nga Asambleja.

2. a) Asambleja:

i) do të merret me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen dhe zhvillimin e bashkimit dhe zbatimin e Traktatit;

ii) do të ushtrojë të drejta të tilla dhe do të përmbushë detyra të tilla që janë veçanërisht konform ose të nënshkruara në këtë Traktat;

iii) do t'i japë direktiva Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me përgatitjet e konferencave të rishikimit;

iv) do të shqyrtojë dhe aprovojë raportet dhe aktivitetet e Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me bashkimin dhe do t'i japë atij të gjitha instruksionet e nevojshme për çështjet brenda kompetencave të bashkimit;

v) do të krijojë të tilla komitete dhe grupe pune, në qoftë se kjo gjykohet e përshtatshme për të ndihmuar punën e bashkimit;

vi) do të përcaktojë, varësisht paragrafit (1)(d), se cili shtet tjetër nga ata kontraktues, cila organizatë ndërqeveritare tjetër nga ato organizata ndërqeveritare të pronësisë industriale siç përcaktohet në nenin 2(v) dhe cila organizatë ndërkombëtare joqeveritare do të lejohen të marrin pjesë në mbledhjet e saj si vëzhgues dhe në çfarë përmasash do të lejohen autoritetet ndërkombëtare të depozitimit të marrin pjesë në mbledhje si vëzhgues;

vii) do të ndërmarrë çdo veprim tjetër të përshtatshëm të projektuar për të çuar më përpara objektivat e bashkimit;

viii) do të kryejë funksione të tjera të tilla ashtu siç janë përcaktuar në këtë Traktat.

b) Në lidhje me çështjet të cilat janë gjithashtu të interesit për bashkimet e tjera administruar nga Organizata, Asambleja do të marrë vendime, pasi të ketë dëgjuar sugjerimin e Komitetit të Koordinimit të Organizatës.

3. Një delegat mund të jetë i pranishëm dhe të votojë në emër vetëm të një shteti.

4. Secili Shtet Kontraktues do të ketë një votë.

5. a) Gjysma e Shteteve Kontraktuese do të përbëjë kuorumin.

b) Në mungesë të kuorunit, Asambleja mund të marrë vendime, por me përjashtim të vendimeve që kanë të bëjnë me procedurat e saj, të gjitha të tjerat do të kenë efekt vetëm në qoftë se kuorumi dhe shumica e nevojshme arrihen nëpërmjet votimit në korrespondencë ashtu siç jepet në rregulloret.

6. a) Varësisht neneve 8(1)(c), 12(4), 14(2)(b), vendimet e Asamblesë do të kërkojnë shumicën e votave të hedhura.

b) Abstenimet nuk do të konsiderohen votë.

7. a) Asambleja do të mbledhet një herë në çdo dy vite kalendarike në sesion të zakonshëm me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm dhe preferohet që të mbledhet gjatë të njëjtës periudhë dhe në të njëjtin vend me atë të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës.

b) Asambleja do të mbledhet në sesione të jashtëzakonshme me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm ose me iniciativën e saj, ose me kërkesën e një të katërtës së Shteteve Kontraktuese.

8) Asambleja do të adaptojë rregullat e saj të procedurave.

Neni 11

Byroja Ndërkombëtare

1. Byroja Ndërkombëtare:

i) do të kryejë detyra administrative, që kanë të bëjnë me bashkimin, veçanërisht detyra të tilla siç janë paracaktuar në mënyrë specifike në këtë Traktat dhe në rregulloret ose nga Asambleja;

ii) do të sigurojë sekretariatën e konferencave të rishikimit të Asamblesë, komiteteve dhe grupeve të punës krijuar nga Asambleja dhe të çdo mbledhjeje tjetër thirrur nga Drejtori i Përgjithshëm dhe që kanë të bëjnë me çështje të interesit të bashkimit.

2. Drejtori i Përgjithshëm do të jetë shefi ekzekutiv i bashkimit dhe do të përfaqësojë bashkimin.

3. Drejtori i Përgjithshëm do të thërrasë mbledhjet që kanë të bëjnë me çështje të interesit të bashkimit.

4. a) Drejtori i Përgjithshëm dhe çdo anëtar i stafit të caktuar prej tij do të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha mbledhjet e Asamblesë, komiteve dhe grupeve të punës krijuar nga Asambleja, dhe në çdo mbledhje tjetër të thirrur nga Drejtori i Përgjithshëm dhe që kanë të bëjnë me çështje të interesit të bashkimit.

b) Drejtori i Përgjithshëm, ose një anëtar i stafit caktuar prej tij, do të jetë sekretar ex officio i Asamblesë dhe i komiteve, grupeve të punës dhe mbledhjeve të tjera të përmendura në nënparagrafin (a).

5. a) Drejtori i Përgjithshëm, sipas direktivave të Asamblesë, do të bëjë përgatitjet për konferencat e rishikimit.

b) Drejtori i Përgjithshëm mund të konsultohet me organizatat ndërqeveritare dhe ato joqeveritare ndërkombëtare në lidhje me përgatitjet për konferencat e rishikimit.

c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar nga ai do të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutime në konferencat e rishikimit.

d) Drejtori i Përgjithshëm ose një anëtar i stafit i caktuar prej tij, do të jetë sekretar ex officio i çdo konference të rishikimit.

Neni 12 **Rregulloret**

1. Rregulloret sigurojnë rregulla në lidhje me:

i) çështjet përsa u përket të cilave ky Traktat qartësisht i referohet rregulloreve ose që qartësisht sigurohet që ato janë përshkruar ose do të përshkruhen;

ii) çdo kërkesë administrative, çështje ose procedura;

iii) çdo detaj të dobishëm në zbatimin e këtij Traktati.

2. Rregulloret e adaptuara në të njëjtën kohë me këtë Traktat janë shtojcë e këtij Traktati.

3. Asambleja mund të ndryshojë rregulloret.

4. a) Vartësisht nënparagrafit (b), adaptimi i çdo ndryshimi i rregulloreve do të kërkojë dy të tretat e votave të hedhura.

b) Adaptimi i çdo ndryshimi, në lidhje me sigurimin e mostrave të mikroorganizmave të depozituar nga autoritetet ndërkombëtare të depozitimit do të kërkojë që asnjë Shtet Kontraktues të votojë kundër ndryshimeve të propozuara.

5. Në rastet e konfliktit ndërmjet dispozitave të këtij Traktati dhe atyre të rregulloreve, dispozitat e këtij Traktati do të jenë mbizotëruese.

KAPITULLI III RISHIKIMI DHE NDRYSHIMI

Neni 13 **Revizionimi i Traktatit**

1. Ky Traktat mund të jetë i rishikueshëm kohë pas kohe nga konferencat e Shteteve Kontraktuese.

2. Thirrja e çdo konference për rishikim do të vendoset nga Asambleja.

3. Nenit 10 dhe 11 mund të jenë rishikuar ose me anë të një konference rishikimi, ose sipas nenit 14.

Neni 14 **Ndryshimi i dispozitave të caktuara të Traktatit**

1. a) Propozimet sipas këtij neni për ndryshim të nenit 10 dhe 11 mund të iniciohen nga çdo Shtet Kontraktues ose nga Drejtori i Përgjithshëm.

b) Këto propozime duhet t'u komunikohen nga Drejtori i Përgjithshëm, Shteteve Kontraktuese të paktën gjashtë muaj përpara shqyrtimit të tyre nga Asambleja.

2. a) Ndryshimet në nenet e përmendura në paragrafin (1) do të adaptohen nga Asambleja.
- b) Adaptimi i çdo ndryshimi të nenit 10 do të kërkojë katër të pestat e votave të hedhura; adaptimi i çdo ndryshimi të nenit 11 do të kërkojë tre të katërtat e votave të hedhura.
3. a) Çdo ndryshim i neneve të përmendura në paragrafin (1) do të hyjë në fuqi një muaj pas njoftimeve me shkrim të pranimit, kryer sipas proceseve kushtetuese respektive të tyre, marrë nga Drejtori i Përgjithshëm nga tre të katërtat e anëtarëve të Shteteve Kontraktuese të Asamblesë në kohën që Asambleja adaptonte ndryshimet.
- b) Çdo ndryshim në nenet e përmendura të pranuar në këtë mënyrë do të jetë i detyrueshëm për të gjitha Shtetet Kontraktuese, të cilat ishin Shtete Kontraktuese në kohën që u adaptua ndryshimi nga Asambleja, me kusht që çdo ndryshim që sjell detyrime financiare për Shtetet Kontraktuese të përmendura ose që rrit këto detyrime do të jetë detyrues vetëm për ato Shtete Kontraktuese, të cilat kanë njoftuar pranimin e këtyre ndryshimeve.
- c) Çdo ndryshim i pranuar, i cili ka hyrë në fuqi sipas nënparagrafit (a) do të jetë i detyrueshëm për të gjitha shtetet të cilat bëhen Shtete Kontraktuese pas datës në të cilën është pranuar ndryshimi nga Asambleja.

KAPITULLI IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15 **Bërja Palë në Traktat**

1. Çdo shtet anëtar i Bashkimit Ndërkombëtar (të Parisit) për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale mund të bëhet Palë në këtë Traktat me:
- i) nënshkrimin pasuar nga depozitimi i një instrumenti të ratifikimit;
 - ii) depozitimin e një instrumenti të pranimit.
2. Instrumentet e ratifikimit ose pranimit depozitohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 16 **Hyrja në fuqi e Traktatit**

1. Ky Traktat do të hyjë në fuqi, përsa i përket pesë shteteve të para, të cilat kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose pranimit, tre muaj pas datës në të cilën të jetë depozituar instrumenti i pestë i ratifikimit ose pranimit.
2. Ky Traktat do të hyjë në fuqi, përsa i përket çdo shteti tjetër, tre muaj pas datës në të cilën shteti ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose pranimit, me kusht që të mos jetë shënuar në instrumentin e ratifikimit ose pranimit një datë e mëvonshme. Në rastin e fundit, ky Traktat do të hyjë në fuqi, përsa i përket shtetit, në datën e shënuar.

Neni 17 **Denoncimi i Traktatit**

1. Çdo Shtet Kontraktues mund ta denoncojë këtë Traktat me anë të njoftimit adresuar Drejtorit të Përgjithshëm.
2. Denoncimi do të ketë efekt dy vjet pas ditës, në të cilën Drejtori i Përgjithshëm merr njoftimin.
3. E drejta e denoncimit siguar në paragrafin (1) nuk ushtrohet nga asnjë Shtet Kontraktues përpara përfundimit të pesë viteve nga data në të cilën bëhesh Palë në këtë Traktat.
4. Denoncimi i këtij Traktati nga një Shtet Kontraktues, që ka bërë një deklaratë sipas nenit 7(1)(a) përsa i përket një institucioni depozitimi, i cili ka përfituar në këtë mënyrë statusin e autoritetit ndërkombëtar të depozitimit, do të gëzojë përfundimin e këtij statusi një vit pas ditës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka marrë njoftimin e përmendur në paragrafin (1).

Neni 18
Nënshkrimi dhe gjuha e Traktatit

1. a) Ky Traktat do të nënshkruhet në një original të vetëm në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, duke qenë të dy tekstet autentike të njëjta.

b) Tekstet zyrtare të këtij Traktati do të hartohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimeve me qeveritë e interesuara dhe brenda dy muajve nga data e nënshkrimit të këtij Traktati, në gjuhët e tjera në të cilat është nënshkruar Konventa e themelimit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.

c) Tekstet zyrtare të këtij Traktati do të hartohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimeve me qeveritë e interesuara, në gjuhën arabe, gjermane, italiane, japoneze dhe portugeze dhe në gjuhë të tjera që mund të caktohen nga Asambleja.

2. Ky Traktat do të mbetet i hapur për nënshkrim në Budapest deri më 31 dhjetor 1977.

Neni 19
Depozitimi i Traktatit; përcjellja e kopjeve; regjistrimi i Traktatit

1. Originali i këtij Traktati do të depozitohet pranë Drejtorit të Përgjithshëm në kohën kur nuk do të jetë më i hapur për nënshkrim.

2. Drejtori i Përgjithshëm do t'u përcjellë nga dy kopje të këtij Traktati dhe rregulloreve, të vërtetuara prej tij, qeverive të të gjitha shteteve të përmendura në nenin 15 (1), organizatave ndërqeveritare që mund të depozitojnë një deklaratë sipas nenit 9(1)(a) dhe me kërkesë, qeverisë së çdo shteti tjetër.

3. Drejtori i Përgjithshëm do të regjistrojë Traktatin pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

4. Drejtori i Përgjithshëm do të përcjellë dy kopje të çdo ndryshimi të këtij Traktati dhe të rregulloreve, të vërtetuara prej tij, të gjitha Shteteve Kontraktuese, të gjitha organizatave ndërqeveritare të pronësisë industriale dhe me kërkesë, qeverisë së çdo shteti tjetër dhe çdo organizate tjetër ndërqeveritare që mund të depozitojë një deklaratë sipas nenit 9(1)(a).

Neni 20
Njoftimet

Drejtori i Përgjithshëm do të njoftojë Shtetet Kontraktuese, organizatat ndërqeveritare të pronësisë intelektuale dhe ato shtete joanëtare të bashkimit, të cilat janë anëtare të Bashkimit Ndërkombëtar (të Parisit) për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale për:

- i) nënshkrimet sipas nenit 18;
- ii) depozitimet e instrumenteve të ratifikimit ose pranimi sipas nenit 15(2);
- iii) deklarinimet e depozituara sipas nenit 9(1)(a) dhe njoftimet e tërheqjes sipas nenit 9(2) ose (3);
- iv) datën e hyrjes në fuqi të këtij Traktati sipas nenit 16(1);
- v) komunikimet sipas nenit 7 dhe 8 dhe vendimet sipas nenit 8;
- vi) pranimin e ndryshimeve të këtij Traktati sipas nenit 14(3);
- vii) çdo ndryshim në rregullore;
- viii) datat në të cilën hyjnë në fuqi ndryshimet e Traktatit dhe rregulloreve;
- ix) denoncimet e marra sipas nenit 17.

L I G J
Nr.9032, datë 20.3.2003

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN
NDËRKOMBËTARE PËR VIJAT E NGARKESËS” 1966**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën ndërkombëtare për vijat e ngarkesës” 1966.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3777, datë 16.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

KONVENTA
NDËRKOMBËTARE E VIJAVE TË NGARKESËS, 1966

Qeveritë Kontraktuese,
duke dashur të vendosin parime dhe rregulla uniforme lidhur me ligjet dhe kufijtë, në të cilat anijet në udhëtime ndërkombëtare mund të ngarkohen duke pasur parasysh nevojën për ruajtjen e jetës dhe pasurisë në det;

duke besuar se mënyra më e mirë për arritjen e këtij qëllimi është konkludimi i një Konvente,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Detyrime të përgjithshme të Konventës

1. Qeveritë Kontraktuese marrin përsipër të vënë në veprim kërkesat e kësaj Konvente dhe anekseve bashkëngjitur, të cilat përbëjnë pjesë të pandara të saj. Çdo referim i kësaj Konvente përbën në të njëjtën kohë edhe një referim ndaj anekseve të saj.

2. Qeveritë Kontraktuese do të marrin të gjitha masat që mund të jenë të nevojshme për vënien në zbatim të kësaj Konvente.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Konvente, nëse nuk shprehet ndryshe:

1. “Rregulla” do të thotë rregullat aneksuar kësaj Konvente.
2. “Administrata” do të thotë qeveria e shtetit, flamurin e të cilit ka anija.
3. “I miratuar” do të thotë i miratuar nga administrata.
4. “Udhëtim ndërkombëtar” do të thotë lundrim detar nga një vend ku Konventa në fjalë është në fuqi, në një port jashtë këtij vendi ose anasjelltas. Këtu, konsiderohet si një vend i veçantë çdo

territor për marrëdhëniet ndërkombëtare, të të cilit ka një Qeveri Kontraktuese, që është përgjegjëse ose për të cilin Kombet e Bashkuara janë autoriteti administrues.

5. "Anije peshkimi" është një anije që përdoret për zënie peshku, balenash, fokash, luanë deti ose çdo lloj qeniesh të gjalla të detit.

6. "Anije e re" do të thotë një anije, fundi i së cilës është ndërtuar ose që është në një fazë të ngjashme konstruksioni, në ose mbas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për secilën Qeveri Kontraktuese.

7. "Anije ekzistuese" do të thotë një anije që nuk është anije e re.

8. "Gjatësi" do të thotë 96% e gjatësisë totale në vijën e ujit në 85% të thellësisë më të vogël të brendshme të matur nga maja e fundit ose gjatësia nga pjesa e përparme e sistemit deri tek aksi i boshtit të timonit në këtë vijë uji, nëse kjo është më e madhe.

Neni 3

Dispozita kryesore

1. Asnjë anije, për të cilën kjo Konventë zbatohet, nuk do të dalë në det për të kryer një udhëtim ndërkombëtar pas datës në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi nëse nuk është kontrolluar, shënuar dhe pajisur me një certifikatë ndërkombëtare të vijave të ngarkesës (1966) ose, kur është rasti, me një certifikatë ndërkombëtare përjashtimi të vijës së ngarkesës në përputhje me kërkesat e kësaj Konvente.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk e pengon administratën për të caktuar një bord të lirë më të madh nga bordi i lirë i caktuar në përputhje me aneksin 1.

Neni 4

Zbatimi

1. Kjo Konventë do të zbatohet për:

- a) anije të regjistruara në vende, qeveritë e të cilave janë Qeveri Kontraktuese;
 - b) anije të regjistruara në territore, tek të cilat kjo Konventë aplikohet sipas nenit 32;
 - c) anije të paregjistruara me flamurin e një shteti, qeveria e të cilit është Qeveri Kontraktuese.
2. Konventa do të zbatohet për anijet që angazhohen në udhëtime ndërkombëtare.
3. Rregullat që përmban aneksi 1 zbatohen në mënyrë të veçantë për anijet e reja.

4. Anijet ekzistuese që nuk përmbushin kërkesat e rregullave të aneksit 1 apo ndonjë pjesë të tyre duhet të plotësojnë përkatësisht ato kërkesa minimale që administrata zbaton për anijet në udhëtime ndërkombëtare përpara ardhjes në fuqi të kësaj Konvente; në asnjë rast anije të tilla nuk do të kërkohen të rrisin bordin e lirë. Me qëllim që të përfitohet nga reduktime të bordit të lirë nga ai i caktuar më parë, anijet ekzistuese do të përmbushin të gjitha kërkesat e kësaj Konvente.

5. Rregullat e përmbajtura në aneksin 2 janë të zbatueshme për anijet e reja dhe ekzistuese, për të cilat kjo Konventë zbatohet.

Neni 5

Përjashtimet

1. Kjo Konventë nuk do të zbatohet për:

- a) Anijet e luftës
- b) Anijet e reja me gjatësi nën 24 metra (79 këmbë)
- c) Anijet ekzistuese nën 150 ton bruto
- d) Jahte turistike të paangazhuara në tregti
- e) Anijet e peshkimit

2. Asgjë në këtë Konventë nuk do të aplikohet për anijet që lundrojnë vetëm në:

a) Liqenet e mëdhenj të Amerikës së Veriut dhe lumit St. Lawrence deri në një vijë në formë rombi të hequr në drejtim të lindjes, nga Cap de Rosiers në pikën perëndimore, ishulli Anticosti dhe në anën veriore të ishullit Anticosti, meridiani i gjatësisë 630 në perëndim.

b) Deti Kaspik.

c) Lumenjtë Plate, Parana dhe Uruguaj deri në vijën në trajtë rombi të hequr në drejtim të

lindjes ndërmjet Punta Rasa (Caba San Antonio), Argjentinës dhe Punta del Este, Uruguaj.

Neni 6 **Përrjashtime**

1. Kur anijet angazhohen në udhëtime ndërkombëtare ndërmjet porteve fqinje të dy ose më shumë shteteve, ato mund të përjashtohen nga administrata prej kërkesave të kësaj Konvente, për sa kohë që do të mbeten të angazhuara në udhëtime të tilla, nëse qeveritë e shteteve ku këto porte ndodhen kanë bindjen se natyra e mbrojtur apo kushtet e një lundrimi të tillë ndërmjet këtyre porteve e bëjnë të paarsyeshme ose jopraktike zbatimin e kërkesave të kësaj Konvente për anijet e angazhuara në këto lundrime.

2. Administrata mund të përjashtojë ato anije që materializojnë cilësi të një lloji të ri, nga çdonjëra prej kërkesave të kësaj Konvente, zbatimin e cilësive të tilla, si dhe inkorporimin e tyre në anijet që angazhohen në udhëtime ndërkombëtare. Çdo anije e tillë duhet megjithatë të përmbushë kërkesat e sigurisë, të cilat në opinionin e kësaj administrate janë të përshtatshme për shërbimin për të cilin është destinuar dhe janë të tilla që të sigurojnë në përgjithësi sigurinë e anijes dhe janë të pranueshme për qeveritë e shteteve që do të preken nga anija.

3. Administrata që lejon përjashtime si në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, do t'i komunikojë Organizatës Detare Konsultative Ndërqeveritare (këtu më poshtë e quajtur Organizata) hollësitë e këtij përjashtimi dhe arsyet përkatëse të cilat Organizata do t'ua qarkullojë Qeverive Kontraktuese për informim.

4. Një anije, e cila nuk është normalisht e angazhuar në udhëtime ndërkombëtare, por, e cila në rrethana të pazakonshme kërkohet të ndërmarrë një udhëtim të vetëm ndërkombëtar, administrata mund ta përjashtojë nga secila prej kërkesave të kësaj Konvente, me kusht që ajo të përmbushë kërkesat e sigurisë, të cilat, në opinionin e kësaj administrate, janë të mjaftueshme për udhëtimin që ajo do të ndërmarrë.

Neni 7 **Forcë madhore**

1. Një anije, që nuk është subjekt i kërkesave të kësaj Konvente, në kohën e nisjes së saj për udhëtim, nuk do të bëhet subjekt i këtyre kërkesave në rast devijimi nga udhëtimi i planifikuar për shkak të kohës së keqe ose ndonjë force madhore.

2. Në zbatimin e kërkesave të kësaj Konvente, Qeveritë Kontraktuese do t'i kushtojnë kujdesin e duhur devijimit ose vonësës së çdo anijeje për shkak të motit ose çdo lloji force madhore tjetër.

Neni 8 **Ekuivalente**

1. Administrata mund të lejojë përdorimin e një konstruksioni, materiali, pajisjeje ose aparati, vendosjen e çdo lloji kërkesë tjetër të ndryshme nga ajo që kërkon kjo Konventë, nëse bindet, nëpërmjet provave ose në mënyrë tjetër, se kjo pjesë, materiali, pajisje ose aparat apo kërkesë është të paktën po aq efektive sa dhe ajo që kërkohet nga Konventa.

2. Administrata që lejon një konstruksion, material, pajisje, aparat ose kërkesë të ndryshme nga ajo që kërkohet nga Konventa, do t'i komunikojë Organizatës të dhënat përkatëse për qarkullim Qeverive Kontraktuese, së bashku me një raport të provave të bëra.

Neni 9 **Miratime për qëllime eksperimentale**

1. Asgjë në Konventën në fjalë nuk e ndalon një administratë të bëjë miratime të veçanta për qëllime eksperimentale, përsa i përket një anijeje, për të cilën kjo Konventë zbatohet.

2. Administrata që bën një miratim të tillë do t'i komunikojë Organizatës hollësitë përkatëse

për qarkullim, Qeverive Kontraktuese.

Neni 10

Riparimet, ndryshimet dhe modifikimet

1. Një anije që i nënshtrohet riparimeve, ndryshimeve, modifikimeve dhe përkatësisht ndërrimit të pajisjeve, do të vazhdojë t'i përmbushë të paktën kërkesat që zbatoheshin më parë për këtë anije. Një anije ekzistuese, në një rast të tillë, nuk do t'u nënshtrohej kërkesave në mënyrë më të paktë sesa u nënshtrohej më parë.

2. Riparimet, ndryshimet dhe modifikimet e një karakteri madhor dhe ndërrimi i pajisjeve në këto raste, duhet të plotësojnë kërkesat për një anije të re aq sa administrata e shikon të arsyeshme dhe praktike.

Neni 11

Zonat dhe rajonet

1. Një anije, për të cilën kjo Konventë aplikohet, do të përmbushë edhe kërkesat që aplikohen për këtë anije në zonat dhe rajonet e përshkruara në aneksin 2.

2. Një port që ndodhet në vijën e kufirit ndërmjet dy zonave ose rajoneve do të konsiderohet si brenda zonës ose rajonit nga apo në të cilën anija mbërrin ose largohet.

Neni 12

Zhytja e anijes

1. Përveç rasteve të parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, vijat përkatëse të ngarkesës në anët e anijes, që i korrespondojnë stinës së vitit dhe zonës ose rajonit në të cilin mund të ndodhet anija, nuk do të jenë të zhytura në asnjë moment të ndodhjes së anijes në det, gjatë udhëtimit ose në mbërritje.

2. Kur një anije është në ujë të ëmbël me densitet sa njësia, vija përkatëse e ngarkesës mund të zhytet sa sasia e lejuar për ujë të ëmbël e treguar në certifikatën ndërkombëtare të vijës së ngarkesës (1966).

Kur densiteti është i ndryshëm nga njësia, do të lejohet një kuotë në proporcion me diferencën ndërmjet 1.025 dhe densitetit faktik.

3. Kur një anije largohet nga një port që ndodhet në lumë ose ujëra të brendshme, ngarkimi me zhytje më të madhe do të lejohet në varësi të peshës së lëndës djegëse dhe materialeve të tjera që do të kërkohen për konsum ndërmjet pikës së nisjes dhe mbërritjes.

Neni 13

Survejimi, inspektimi dhe marketimi

Survejimi, inspektimi dhe marketimi i anijeve, përsa i përket forcimit të kërkesave të kësaj Konvente dhe dhënies së përjashtimeve sipas saj, do të kryhet nga oficerët e administratës. Administrata mundet megjithatë, t'ia besojë survejimin, inspektimin dhe marketimin ose survejuesve të emëruar për këtë qëllim ose organizatave të njohura prej saj. Në çdo rast administrata në fjalë garanton plotësisht tërësinë dhe vlefshmërinë e survejimit, inspektimit dhe marketimit.

Neni 14

Survejet dhe inspektimet fillestare e periodike

1. Një anije mund të jetë subjekt i survejimeve dhe inspektimeve siç specifikohet më poshtë:

a) Survejim përpara se anija të futet në shfrytëzim, i cili përfshin një inspektim të plotë të strukturës dhe pajisjeve të saj përsa mbulon kjo Konventë. Ky survejim do të jetë i tillë që të sigurojë se konstruksioni, materiali dhe trarët të përmbushin plotësisht kërkesat e kësaj Konvente.

b) Survejimi periodik në intervalet e përcaktuara nga administrata, por që nuk i kalon 5 vjetët, i cili do të jetë i tillë që të sigurojë se struktura, pajisjet, sistemi, materiali dhe trarët të jenë në përputhje me kërkesat e kësaj Konvente.

c) Inspektimi periodik brenda tre muajve para ose prapa datës së inspektimit vjetor, për të siguruar se nuk janë bërë ndryshime të tilla në skaf apo superstrukturë, që të influencojnë në llogaritjet që përcaktojnë pozicionin e vijës së ngarkesës dhe për të siguruar mirëmbajtjen në gjendje normale të instalimeve dhe pajisjeve për:

1. mbrojtjen e daljeve
2. grilave mbrojtëse
3. portat
4. mjetet e hyrjes në ambientet e ekuipazhit

2. Inspektimet periodike referuar në paragrafin 1 të këtij neni do të shënohen në certifikatën ndërkombëtare të vijës së ngarkesës (1966) ose në certifikatën ndërkombëtare të përjashtimit të vijës së ngarkesës, që i lëshohet një anijeje të përjashtuar sipas paragrafit 2 të nenit 6 të kësaj Konvente.

Neni 15

Ruajtja e gjendjes pasurvejimit

Pas përfundimit të çdo lloj survejimi të anijes sipas nenit 14, asnjë ndryshim nuk mund të bëhet në strukturë, pajisje, sisteme, materiale ose trarë që prek ky survejim, pa sanksionimin e administratës.

Neni 16

Dhënia e certifikatave

1. Certifikata ndërkombëtare e vijës së ngarkesës (1966) i jepet çdo anijeje, e cila ështëurvejuar dhe shënuar në përputhje me këtë Konventë.

2. Certifikata ndërkombëtare përjashtimi i vijës së ngarkesës (1966) i jepet çdo anijeje, së cilës i është dhënë përjashtim sipas dhe në përputhje me paragrafin 2 ose 4 të nenit 6.

3. Këto certifikata do të jepen nga administrata ose nga persona, ose organizata të autorizuara nga ajo. Në çdo rast, administrata merr përgjegjësi të plotë për certifikatën.

4. Pavarësisht nga kërkesa të tjera të Konventës, çdo certifikatë ndërkombëtare e vijës së ngarkesës që është korrente kur kjo Konventë vjen në fuqi përta i përket qeverisë së shtetit, flamurin e të cilit mban anija, mbeten të vlefshme për dy vjet ose deri në dekadencën e saj, cila të jetë më parë. Mbas kësaj kohe, kërkohet një certifikatë ndërkombëtare e vijës së ngarkesës (1966).

Neni 17

Dhënia e certifikatës nga një qeveri tjetër

1. Një Qeveri Kontraktuese mundet me kërkesën e një Qeverie tjetër Kontraktuese, të bëjëurvejimin e një anijeje dhe nëse bindet që kërkesat e kësaj Konvente përmbushen, të pajisë ose të autorizojë pajisjen e anijes me një certifikatë ndërkombëtare të vijës së ngarkesës (1966) në përputhje me Konventën.

2. Një kopje e certifikatës, një kopje e raportit tëurvejimit të përdorur për llogaritjen e bordit të lirë dhe një kopje e llogaritjeve do t'i transmetohen sa më parë qeverisë kërkuese.

3. Një certifikatë e dhënë në këtë mënyrë, duhet të përmbajë një deklaratë me efektin se kjo është dhënë me kërkesën e qeverisë së shtetit, flamurin e të cilit ka ose do të ketë anija dhe se do të ketë të njëjtën njohje si një certifikatë e lëshuar sipas nenit 16.

4. Nuk mund t'i lëshohet certifikatë ndërkombëtare e vijës së ngarkesës (1966) një anijeje që mban flamurin e një shteti, qeveria e të cilit nuk është Qeveri Kontraktuese.

Neni 18
Forma e certifikatave

1. Certifikatat do të hartohen në gjuhën ose gjuhët zyrtare të vendit që i lëshon. Nëse gjuha e përdorur nuk është as anglisht, as frëngjisht, teksti do të përmbajë një përkthim në njërën nga këto gjuhë.

2. Forma e certifikatës do të jetë ajo e modeleve të dhëna në aneksin 3. Paraqitja e tekstit të shtypur të certifikatave standarde do të riprodhohet në mënyrë ekzakte në certifikatat që lëshohen dhe në kopjet e tyre të vërtetuara.

Neni 19
Kohëzgjatja e certifikatës

1. Certifikata ndërkombëtare e vijës së ngarkesës (1966) lëshohet për një periudhë të specifikuar nga administrata, por që nuk kalon 5 vjet nga data e lëshimit.

2. Nëse mbasurvejimit periodik të referuar në paragrafin 1(b) të nenit 14, një certifikatë e re nuk mund t'i lëshohet anijes përpara zhvlefësisimit të certifikatës së lëshuar fillimisht, personi ose organizata që kryenurvejimin mund të zgjasë vlefshmërinë e certifikatës, për një periudhë që nuk i kalon 5 muaj. Kjo zgjatje do të pasqyrohet e kundërfirmosur në certifikatë dhe do të jepet vetëm kur nuk ka pasur ndryshime në strukturë, pajisje, sistemim, materiale apo trarë, të cilët të ndikojnë në bordin e lirë të anijes.

3. Një certifikatë ndërkombëtare e vijës së ngarkesës (1966) do të anulohet nga administrata nëse ekziston një nga rrethanat e mëposhtme:

a) janë bërë ndryshime të tilla të materialeve të superstrukturës ose të skafit, të cilat bëjnë të nevojshme përcaktimin e një bordi të lirë të rritur;

b) instalimet dhe pajisjet e përmendura në nënparagrafin c të paragrafit 1 të nenit 14 nuk mbahen në gjendje normale;

c) certifikata nuk është kundërshtuar për të treguar se anija është e inspektuar, siç kërkohet në nënparagrafin c të paragrafit 1 të nenit 14;

d) qëndrueshmëria e strukturës së anijes është ulur në një shkallë të tillë që anija nuk është e sigurt.

4. Kohëzgjatja e një certifikate ndërkombëtare të vijës së ngarkesës (1966), lëshuar një anijeje nga administrata të përjashtuar nënparagrafin 2 të nenit 6 nuk duhet të kalojë 5 vjet nga data e lëshimit. Kjo certifikatë do të jetë objekt i procedurës së rinovimit, kundërshtimit dhe anulimit njësoj siç parashikohet për një certifikatë ndërkombëtare të vijës së ngarkesës (1966) në këtë nen.

Kohëzgjatja e një certifikate ndërkombëtare përjashtimi të vijës së ngarkesës (1966) lëshuar një anijeje të përjashtuar sipas paragrafit 4 të nenit 6 do të kufizohet në udhëtimin e vetëm për të cilin është lëshuar.

5. Certifikata e lëshuar një anijeje nga një administratë do të pushojë së qeni e vlefshme me transferimin e anijes në flamurin e një shteti tjetër.

Neni 20
Pranimi i certifikatës

Certifikatat e lëshuara nën autoritetin e një Qeverie Kontraktuese në përputhje me këtë Konventë do të pranohet nga Qeveritë e tjera Kontraktuese dhe do të konsiderohet për çdo rast që mbulohet nga kjo Konventë me të njëjtën fuqi si certifikatë e lëshuar prej tyre.

Neni 21
Kontrolli

1. Anijet që mbajnë një certifikatë të lëshuar sipas nenit 16 ose 17 janë subjekt, kur ndodhen në portet e Qeverive të tjera Kontraktuese, i kontrollit nga oficerë të autorizuar nga këto qeveri. Qeveritë Kontraktuese do të sigurojnë që ky kontroll të ushtrohet përderisa është e arsyeshme dhe

praktike, me qëllim që të verifikojë që në bordin e anijes ndodhet një certifikatë e vlefshme sipas kësaj Konvente. Nëse në bord ndodhet një certifikatë e vlefshme ndërkombëtare e vijës së ngarkesës (1966), ky kontroll do të kufizohet të përcaktojë se:

- a) anija nuk është e ngarkuar përtej kufijve të lejuar nga certifikata;
- b) pozicioni i vijës së ngarkesës së anijes i korrespondon certifikatës;
- c) anija nuk është ndryshuar materialisht në mënyrë të tillë që për nga pikëpamja e problemeve që shtrohen në nënparagrafët a dhe b të paragrafit 3 të nenit 19, anija është dukshëm e papërshtatshme për të dalë në det pa rrezik për jetën e njeriut.

Nëse ka një certifikatë të vlefshme ndërkombëtare të vijës së ngarkesës (1966) në bord, qëllimi i një kontrolli të tillë do të kufizohet të përcaktojë përmbushjen e kushteve të paraqitura në këtë certifikatë.

2. Nëse një kontroll i tillë ushtrohet në nënparagrafin c të paragrafit 1 të këtij neni, ky kontroll do të ushtrohet për aq sa është e nevojshme të sigurohet që anija nuk do të lundrojë derisa mund të dalë në det pa rrezik për pasagjerët ose ekuipazhin.

3. Në rastin e kontrollit që sipas këtij neni jep rast për ndërhyrje të çdo lloji, oficeri që kryen kontrollin do të njoftojë menjëherë me shkrim konsullin ose përfaqësuesin diplomatik të shtetit, flamurin e të cilit mban anija, për këtë vendim dhe për të gjitha rrethanat në të cilat ndërhyrja ishte gjykuar si e nevojshme.

Neni 22

Privilegjet

Privilegjet e kësaj Konvente nuk mund të kërkojnë në favor të asnjë anijeje, nëse ajo nuk mban një certifikatë të vlefshme sipas kësaj Konvente.

Neni 23

Aksidentet

1. Çdo administratë merr përsipër të kryejë investigimin e aksidenteve që u ndodhin anijeve për të cilat është përgjegjëse dhe që janë subjekt i kërkesave të kësaj Konvente, kur gjykon se një investigim i tillë mund të ndihmojë për të përcaktuar se çfarë ndryshimesh të dobishme mund të bëhen në Konventë.

2. Çdo Qeveri Kontraktuese merr përsipër të furnizojë Organizatën me informacionet përkatëse që lidhen me konstatimet e këtyre investigimeve.

3. Raportet ose rekomandimet e Organizatës, të cilat bazohen në këto informacione, nuk do të zbulojnë identitetin apo nacionalitetin e anijeve në fjalë dhe në asnjë formë nuk do të fiksojnë apo të nënkuptojnë përgjegjësi mbi asnjë anije ose person.

Neni 24

Traktate dhe Konventa të mëparshme

1. Të gjitha traktatet e tjera dhe marrëveshjet që lidhen me çështjet e vijave të ngarkesave në fuqi aktualisht ndërmjet Qeverive Palë të kësaj Konvente, do të vazhdojnë të kenë efekt të plotë në afatet e veprimit të tyre, në rastin:

- a) e anijeve, për të cilat kjo Konventë nuk vepron;
- b) e anijeve, për të cilat kjo Konventë vepron, por për çështje që ajo nuk shprehet.

2. Megjithatë, në atë masë që këto traktate, konventa ose marrëveshje kontradiktojnë me dispozitat e kësaj Konvente, këto të fundit janë përcaktuese.

Neni 25

Rregulla të veçanta të formuluar në bazë marrëveshjeje

Kur në përputhje me këtë Konventë rregulla të veçanta formulohen me marrëveshje ndërmjet të gjitha ose të disa prej Qeverive Kontraktuese, këto rregulla do t'i komunikohen Organizatës për qarkullim të gjitha Qeverive Kontraktuese.

Neni 26
Komunikimi i informacionit

1. Qeveritë Kontraktuese marrin përsipër të komunikojnë me Organizatën dhe të depozitojnë pranë saj:

a) Një numër të mjaftueshëm formatesh të certifikatave të emetuara prej tyre në dispozicion të kësaj Konvente, për qarkullim Qeverive Kontraktuese.

b) Tekstin e ligjeve, dekreteve, urdhrave, rregullave dhe instrumenteve të tjera, të cilat janë promulguar për probleme të ndryshme të kësaj Konvente.

c) Një listë të agjencive joqeveritare, të cilat janë të autorizuar të veprojnë në emrin e tyre në administrimin e çështjeve të vijës së ngarkesës, për qarkullim Qeverive Kontraktuese.

2. Çdo Qeveri Kontraktuese pranon të verë në dispozicion standardet e saj të qëndrueshmërisë nëse kërkohen nga një Qeveri tjetër Kontraktuese.

Neni 27
Nënshkrimi, pranimi dhe bashkimi

1. Kjo Konventë do të mbetet e hapur për nënshkrim për tre muaj nga 5 prilli 1966 dhe më pas do të mbetet e hapur për bashkim. Qeveritë e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara ose të ndonjëres nga agjencitë e specializuara, ose të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, ose Palë të Statutit të Gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë mund të bëhen Palë të Konventës duke:

a) nënshkruar pa rezervë, përsa i përket pranimi,

b) nënshkruar subjekti i pranimi i ndjekur nga pranimi,

c) bashkim.

2. Pranimi ose bashkimi kryhet me depozitimin e një instrumenti pranimi ose bashkimi në Organizatë, e cila informon të gjitha qeveritë që kanë nënshkruar Konventën ose bashkuar në të, për çdo pranim të ri ose bashkim, si dhe datën e depozitimit.

Neni 28
Ardhja në fuqi

1. Kjo Konventë do të vijë në fuqi 12 muaj pas datës në të cilën jo më pak se 15 qeveri të shteteve, që përfshijnë 7 shtete me jo më pak se 1 milion ton bruto anije, kanë shpenzuar pa rezervim për sa i përket pranimi ose kanë depozituar instrumente të pranimi ose aksedimit në përputhje me nenin 27. Organizata do të informojë të gjitha qeveritë që kanë nënshkruar ose akseduar në këtë Konventë për datën në të cilën ajo hyn në fuqi.

2. Për qeveritë të cilat kanë depozituar një instrument pranimi për ose aksedimi në Konventë gjatë 12 muajve të përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, pranimi ose aksedimi ekzekutohet me ardhjen në fuqi të kësaj Konvente ose 3 muaj pas depozitimit të instrumentit cilado që të jetë data e mëpasme.

3. Për qeveritë të cilat kanë depozituar një instrument pranimi për apo aksedimi në këtë Konventë mbas datës në të cilën ajo vjen në fuqi, Konventa vjen në fuqi 3 muaj mbas depozitimit të instrumentit cilado që të jetë data e mëvonshme.

4. Mbas datës në të cilën të gjitha masat që kërkohen për të sjellë një ndryshim të kësaj Konvente në fuqi janë plotësuar ose të gjitha pranimet shikohen si të dhëna në nën-paragrafin (b) të paragrafit 2 të nenit 29 në rast ndryshimi me pranimin unanim, çdo instrument pranimi ose aksedimi i depozituar do të shikohet si në përputhje me Konventën siç është ndryshuar.

Neni 29
Ndryshimet

1. Kjo Konventë mund të ndryshohet sipas cilësdo nga procedurat e specifikuar në paragrafët e mëposhtëm.

2. Ndryshime mbas shqyrtimeve përbrenda Organizatës:

a) Çdo ndryshim propozuar nga një Qeveri Kontraktuese do t'i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës, i cili e qarkullon atë më pas tek të gjithë anëtarët e Organizatës dhe Qeveritë Kontraktuese të paktën 6 muaj para ndryshimit.

b) Çdo ndryshim i propozuar dhe i qarkulluar si më sipër do t'i referohet Komitetit të Sigurisë Detare të Organizatës për shqyrtim.

c) Qeveritë Kontraktuese të shteteve anëtare ose jo të Organizatës do të kenë të drejtën të marrin pjesë në punimet e Komitetit të Sigurisë Detare për shqyrtimin dhe adaptimin e ndryshimeve.

d) Ndryshimet do të adaptohen me një shumicë prej dy të tretave të Qeverive Kontraktuese që marrin pjesë dhe votojnë në Komitetin e Sigurisë Detare të zgjeruar siç jepet në nënparagrafin (c) të këtij paragrafi (këtu më poshtë referuar si "Komiteti i zgjeruar i Sigurisë Detare" me kushtin që të paktën një e treta e Qeverive Kontraktuese të jetë prezent në kohën e votimit.

e) Ndryshimet e adaptuara në përputhje me nënparagrafin (d) të këtij paragrafi do t'u komunikohen, nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës, të gjitha Qeverive Kontraktuese për pranim.

f) Ndryshimi në një nen të Konventës do të quhet i pranuar në datën në të cilën është pranuar nga dy të tretat e Qeverive Kontraktuese.

Ndryshimi në një aneks do të konsiderohet si i pranuar:

- në përfundimin e dy vjetëve në të cilën ky i është komunikuar Qeverive Kontraktuese për pranim;

- në përfundim të një periudhe të ndryshme, e cila nuk do të jetë më pak se një vit, nëse kështu vendoset në kohën e adaptimit të tij nga një shumicë prej dy të tretave të Qeverive Kontraktuese që janë prezente dhe votojnë në Komitetin e zgjeruar të Sigurisë Detare.

Pavarësisht nga kjo, nëse brenda periudhës së specifikuar ose më shumë se një e treta e Qeverive Kontraktuese, ose një numur i tillë Qeverish Kontraktuese që flotan e tyre tregtare të përbëjnë jo më pak se 50% të tonazhit bruto të flotave tregtare të të gjitha Qeverive Kontraktuese, njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm se ato kundërshtojnë ndryshimin, ky ndryshim do të konsiderohet se nuk është pranuar.

g) Ndryshimi i një neni të Konventës do të hyjë në fuqi në rastin e atyre Qeverive Kontraktuese që e kanë pranuar atë, 6 muaj mbas datës në të cilën ky ndryshim konsiderohet si i hyrë në fuqi dhe në rastin e asaj Qeverie Kontraktuese që e pranon atë mbas kësaj date, 6 muaj mbas datës së pranimit të kësaj qeverie.

i) Ndryshimi në një aneks do të hyjë në fuqi për të gjitha Qeveritë Kontraktuese, përveç atyre që kanë paraqitur objeksione për ndryshimin sipas pikës (f) të këtij paragrafi dhe që nuk i kanë tërhequr këto objeksione, 6 muaj mbas datës në të cilën ky ndryshim quhet i pranuar. Megjithatë, përpara datës së caktuar të hyrjes në fuqi, cilado nga Qeveritë Kontraktuese mund të japë njoftimin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës se e përjashton veten nga vënia në veprim e atij ndryshimi për një periudhë jo më të gjatë se një vit nga data e hyrjes së tij në fuqi, ose për një periudhë aq më të gjatë, siç mund të vendoset nga një shumicë prej dy të tretave të Qeverive Kontraktuese prezente dhe votuese në Komitetin e zgjeruar të Sigurisë Detare në kohën e adaptimit të ndryshimit.

3. Ndryshimi nga një konferencë:

a) Me kërkesën e një Qeverie Kontraktuese të mbështetur nga të paktën një e treta e Qeverive Kontraktuese, Organizata do të thërrasë një konferencë të Qeverive Kontraktuese për të konsideruar ndryshimet në këtë Konventë.

b) Çdo ndryshim i adaptuar nga një konferencë e tillë me një shumicë sa dy të tretat e Qeverive Kontraktuese prezente dhe votuese, do t'u komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës, të gjitha Qeverive Kontraktuese për pranim.

c) Nëse Konferenca nuk vendos ndryshe, ndryshimet do të konsiderohen si të pranura dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e specifikuara respektivisht në nënparagrafët (2)(f) dhe (2)(g) të këtij neni, me kusht që referimet në këta paragrafë Komitetit të zgjeruar të Sigurisë Detare të kuptohen si referime konferencës.

4. a) Një Qeveri Kontraktuese, e cila ka pranuar një ndryshim në një aneks që ka hyrë në fuqi, nuk do të jetë e detyruar të shtrijë përfitimet e kësaj Konvente për sa i përket certifikatave të lëshuara një anijeje që ka të drejtën e mbajtjes së flamurit të një shteti, Qeveria e të cilit, në zbatim të klauzolave të nënparagrafit (2)(f) të këtij neni, nuk ka pranuar ndryshimet dhe nuk e ka tërhequr këtë mospranim, por vetëm në atë shkallë që këto certifikata kanë të bëjnë me çështje që mbulohen nga ndryshimi në fjalë.

b) Një Qeveri Kontraktuese, e cila ka pranuar një ndryshim në një aneks, i cili ka hyrë në fuqi, do të shtrijë përfitimet e kësaj Konvente përsa i përket certifikatave të lëshuara një anijeje që ka të drejtën e flamurit të një shteti, qeveria e të cilit, në zbatim të klauzolave të nënparagrafit (2)(g) të këtij neni, ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës se e përjashton veten nga vënia në veprim e këtij ndryshimi.

5. Nëse nuk jepet shprehimisht ndryshe, çdo ndryshim në këtë Konventë, i bërë sipas këtij neni, që lidhet me strukturën e anijes, do të zbatohet vetëm për anijet, kili i të cilave është shtruar ose që janë në një fazë të ngjashme të ndërtimit në ose pas datës, në të cilën ndryshimi hyn në fuqi.

6. Çdo deklaratë e pranimit ose kundërshtimit të një ndryshimi ose çdo njoftim i dhënë sipas nënparagrafit (2)(g) të këtij neni do t'i dorëzohet e shkruar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës, i cili do të njoftojë të gjitha Qeveritë Kontraktuese për çdo depozitim të tillë dhe për datën në të cilën një ndryshim i tillë hyn në fuqi.

Neni 30 **Denoncimi**

1. Kjo Konventë mund të denoncohet nga çdo Qeveri Kontraktuese në çdo kohë mbas kohës së ekspertimit prej 5 vjetësh nga data, në të cilën Konventa vjen në fuqi për atë qeveri.

2. Denoncimi do të kryhet nëpërmjet një njoftimi me shkrim adresuar Organizatës, e cila do të njoftojë të gjitha Qeveritë e tjera Kontraktuese për çdo njoftim të tillë dhe për datën e marrjes së tij.

3. Një denoncim hyn në veprim mbas një viti ose mbas një periudhe të tillë aq më të gjatë siç mund të specifikohet në notën, mbas marrjes së saj nga Organizata.

Neni 31 **Pezullimi**

1. Në rast armiqësish ose rrethanash të tjera të jashtëzakonshme, të cilat prekin interesat vitale të shtetit, qeveria e të cilit është Qeveri Kontraktuese, kjo qeveri mund të pezullojë funksionimin e tërë Konventës ose të çdo pjese të saj. Qeveria pezulluese do të njoftojë menjëherë për çdo pezullim të tillë Organizatën.

2. Një pezullim i tillë nuk do të përjashtojë Qeveritë e tjera Kontraktuese për çështje që kanë të bëjnë me të drejtën e kontrollit sipas kësaj Konvente mbi anijet e qeverisë pezulluese kur anije të tilla janë brenda porteve të tyre.

3. Qeveria pezulluese mund në çdo kohë të përfundojë një pezullim të tillë dhe do të njoftojë menjëherë me shkrim për një përfundim të tillë.

4. Organizata do të njoftojë të gjitha Qeveritë Kontraktuese për çdo pezullim ose përfundim të tij sipas këtij neni.

Neni 32 **Territoret**

1. Kombet e Bashkuara që janë autoriteti administrues për një territor ose çdo Qeveri Kontraktuese përgjegjëse për marrëdhëniet ndërkombëtare të një territori, do të konsultohen me një territor të tillë sa më parë që të jetë e mundur, në përpjekje për të shtrirë këtë Konventë mbi këtë territor dhe mund që në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim të Organizatës të deklarojnë se kjo Konventë do të shtrihet mbi këtë territor.

Konventa në fjalë do të shtrihet mbi këtë territor nga data e marrjes së këtij njoftimi ose nga ajo datë siç mund të jetë specifikuar në njoftim.

2. Kombet e Bashkuara ose çdo Qeveri Kontraktuese, e cila ka bërë një deklaratë sipas nënparagrafit (a) të paragrafit (1) të këtij neni, në çdo kohë mbas ekspirimit të një periudhe 5-vjeçare nga data e shtrirjes së Konventës në këtë mënyrë mbi një territor, mund që me anë të njoftimit me shkrim të Organizatës të deklarojë se kjo Konventë do të pushojë së qeni në fuqi në territorin e përmendur në njoftim.

Kjo Konventë do të pushojë së zbatuari në territore të përmendura në një njoftim të tillë një vit ose aq sa të jetë specifikuar në të, pas marrjes së njoftimit.

3. Organizata do të njoftojë të gjitha Qeveritë Kontraktuese mbi shtrirjen e kësaj Konvente në territore të paragrafit (1) të këtij neni dhe përfundimin e çdo shtrirjeje sipas paragrafit (2), duke shprehur në çdo rast datën, nga e cila kjo Konventë ka ose do të pushojë kështu së vepruari.

Neni 33
Regjistrimi

1. Kjo Konventë do të depozitohet pranë Organizatës dhe Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës, do të transmetojë kopje të certifikuara të vërteta të saj, të gjitha qeverive nënshkruese dhe të gjitha qeverive që aksedojnë në të.

2. Sapo kjo Konventë hyn në fuqi do të regjistrohet nga Organizata në përputhje me nenin 102 të Çarterit të Kombeve të Bashkuara.

Neni 34
Gjuhët

Kjo Konventë është në një kopje të vetme në gjuhët angleze dhe franceze, të dyja tekstet njësorj autentike. Përkthime zyrtare në rusisht dhe spanjisht do të përgatiten dhe depozitohen bashkë me origjinalin e nënshkruar.

L I G J
Nr.9033, datë 20.3.2003

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E NICËS PËR
KLASIFIKIMIN NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE, PËR
QËLLIMET E REGJISTRIMIT TË MARKAVE**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Nicës për klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve, për qëllimet e regjistrimit të markave.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3778, datë 16.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONVENTA

E NICËS Në lidhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Mallrave dhe Shërbimeve për Qëllimet e Regjistrimit të Markave e 15 Janarit 1957, e rishikuar në Stokholm më 14 Korrik 1967 dhe në Gjenevë më 13 Maj 1977 dhe ndryshuar më 28 Shtator 1979

Neni 1

Themelimi i një Bashkimi të Veçantë; adaptimi i një klasifikimi ndërkombëtar; përcaktimi dhe gjuhët e klasifikimit

1. Vendet ndaj të cilave zbatohet kjo Marrëveshje përbëjnë një Bashkim të Veçantë që adaptojnë një klasifikim të përbashkët të mallrave dhe shërbimeve për qëllimin e regjistrimit të markave (këtej e tutje i quajtur “klasifikimi”).

2. Klasifikimi konsiston në:

i) një listë klasash, së bashku me, sipas rastit, shënime shpjeguese;

ii) një listë alfabetike e mallrave dhe shërbimeve (këtej e tutje e quajtur “lista alfabetike”) me shenjën e klasës, në të cilën përfshihet secili nga mallrat dhe shërbimet.

3. Klasifikimi përmban:

i) klasifikimin e botuar më 1971 nga Zyra Ndërkombëtare e Pronësisë Industriale (këtej tutje e quajtur “Zyra Ndërkombëtare”) e përmendur në Konventën e themelimit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, duke nënkuptuar, sidoqoftë, se shënimet shpjeguese të listës së klasave të përfshira në atë botim, do të konsiderohen si të përkohshme dhe si rekomandime derisa shënimet shpjeguese të listës së klasave të përcaktohen nga Komiteti i ekspertëve përmendur në nenin 3;

ii) ndryshimet dhe shtesat të cilat hyjnë në fuqi, sipas nenit 4(1) të Marrëveshjes së Nicës të 15 janarit 1957 dhe të aktit të Stokholmit të 14 korrikut 1967, e asaj Marrëveshjeje, para hyrjes në fuqi të këtij akti.

iii) çdo ndryshim për t’u bërë në përputhje me nenin 3 të këtij akti dhe që hyn në fuqi sipas nenit 4(1) të këtij akti.

4. Klasifikimi do të jetë në gjuhët angleze dhe franceze, duke qenë të dy tekstet në mënyrë autentikisht të njëjta.

5. a) Klasifikimi i përmendur në paragrafin (3)(i), së bashku me ato të ndryshimeve dhe shtesave të përmendura në paragrafin (3) (ii) që kanë hyrë në fuqi para datës në të cilën ky akt hapet për nënshkrim, përmbahen në kopje autentike në gjuhën franceze, të depozituara pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (këtej e tutje e quajtur “Organizata”). Ato ndryshime dhe shtesa të përmendura në paragrafin (3)(ii) që hyjnë në fuqi pas datës në të cilën ky akt hapet për nënshkrim gjithashtu do të depozitohen në një kopje të vetme autentike, në gjuhën franceze, pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

(b) Versioni anglisht i teksteve të përmendura në nënparagrafin (a) do të përcaktohet nga Komiteti i ekspertëve i përmendur në nenin 3 menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij akti. Kopja e tij autentike do të depozitohet pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

c) Ndryshimet e përmendura në paragrafin (3)(iii) do të depozitohen në një kopje autentike, në gjuhët angleze dhe franceze, pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

6. Tekstet zyrtare të klasifikimit në gjuhët arabe, gjermane, italiane, portugeze, ruse, spanjolle, si dhe në gjuhë të tjera që Asambleja mund të caktojë sipas nenit 5, do të përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimit me qeveritë e interesuara dhe ose mbi bazën e një përkthimi paraqitur nga këto qeveri ose me çdo mjet tjetër i cili nuk shkakton pasoja financiare për buxhetin e Bashkimit të Veçantë ose të Organizatës.

7. Lista alfabetike do të përmendë, në anën e kundërt të çdo shenje të mallrave dhe shërbimeve, një numër serial që është specifik për gjuhën në të cilën përcaktohet kjo listë, së bashku me:

i) në rastin e listës alfabetike të përcaktuar në anglisht, numri serial i përmendur në lidhje me të njëjtën shenjë në listën alfabetike në frëngjisht dhe anasjelltas;

ii) në rastin e çdo liste alfabetike të përcaktuar sipas paragrafit (6), numri serial i përmendur në lidhje me të njëjtën shenjë në listën alfabetike të përcaktuar në anglisht ose në listën alfabetike të përcaktuar në frëngjisht.

Neni 2

Efektet ligjore dhe përdorimi i klasifikimit

1. Duke pranuar kërkesat e përshkruara nga kjo Marrëveshje, efekti i klasifikimit do të jetë ai që i atribuohet atij, nga çdo vend i Bashkimit të Veçantë. Në veçanti, klasifikimi nuk do të detyrojë vendet e Bashkimit të Veçantë në lidhje me mbrojtjen ose vlerësimin e shtrirjes së mbrojtjes akorduar çdo marke të dhënë dhe njohjen ose jo të markave të shërbimit.

2. Secili nga vendet e Bashkimi të Veçantë rezervon të drejtën që ta përdorë klasifikimin ose si një sistem kryesor ose si ndihmës.

3. Zyrat kompetente të vendeve të Bashkimit të Veçantë do të përfshijnë në dokumentet dhe botimet zyrtare në lidhje me regjistrimin e markave numrin e klasave të klasifikimit të cilit i përkasin mallrat dhe shërbimet për të cilat regjistrohet marka.

4. Fakti që një term është përfshirë në listën alfabetike në asnjë mënyrë nuk prek ndonjë të drejtë, e cila mund të ekzistojë në këtë term.

Neni 3

Komiteti i ekspertëve

1. Do të ngrihet një Komitet ekspertësh në të cilin do të përfaqësohet çdo vend i Bashkimit të Veçantë.

2. a) Drejtori i Përgjithshëm, në rast se kërkohet nga Komiteti i ekspertëve, mund dhe do të ftojë vende jashtë Bashkimit të Veçantë, të cilat janë anëtare të Organizatës ose palë të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale, për t'u përfaqësuar nga vëzhgues në mbledhjet e Komitetit të ekspertëve.

b) Drejtori i Përgjithshëm do të ftojë organizata ndërqeveritare të specializuara në fushën e markave, nga të cilat të paktën njëra prej vendeve anëtare është një vend i Bashkimit të Veçantë, për t'u përfaqësuar nga vëzhgues në mbledhjet e Komitetit të ekspertëve.

c) Drejtori i Përgjithshëm, në rast se kërkohet nga Komiteti i ekspertëve, mund dhe do të ftojë përfaqësues të organizatave të tjera ndërqeveritare dhe organizatave ndërkombëtare joqeveritare të marrin pjesë në diskutime, të cilat janë në interes të tyre.

3. Komiteti i ekspertëve:

i) do të vendosë ndryshime në klasifikim;

ii) do t'u drejtojë rekomandime vendeve të Bashkimit të Veçantë, me qëllimin për të lehtësuar përdorimin e klasifikimit dhe nxitjen uniforme të zbatimit të tij;

iii) do të marrë të gjitha masat e tjera, pa shkaktuar pasoja financiare për buxhetin e Bashkimit të Veçantë ose të Organizatës, për të kontribuar drejt lehtësimit të zbatimit të klasifikimit nga vendet në zhvillim;

iv) do të ketë të drejtën të krijojë nënkomitete dhe grupe pune.

4. Komiteti i ekspertëve do të adaptojë rregullat e veta të procedurës. Kjo e fundit do të parashikojë për mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhje të nënkomiteteve dhe grupeve të punës së Komitetit të ekspertëve nga ato organizata ndërqeveritare të përmendura në paragrafin (2)(b), të cilat mund të japin kontribute të rëndësishme në zhvillimin e klasifikimit.

5. Propozimet për ndryshime në klasifikim mund të bëhen zyra kompetente të çdo vendi të Bashkimit të Veçantë, zyra ndërkombëtare, çdo organizatë ndërqeveritare e përfaqësuar në Komitetin e ekspertëve sipas paragrafit (2)(b) dhe çdo vend ose organizatë e ftuar posaçërisht nga Komiteti i ekspertëve të paraqesë këto propozime. Propozimet do t'i komunikohen Zyrës Ndërkombëtare, e cila do t'ua paraqesë ato anëtarëve të Komitetit të ekspertëve dhe vëzhguesve jo më vonë se dy muaj përpara sesionit të Komitetit të ekspertëve, në të cilin propozimet e lartpërmendura do të merren në konsideratë.

6. Çdo vend i Bashkimit të Veçantë do të ketë një votë.

7. a) Duke pranuar nënparagrafin (b), vendimi i Komitetit të ekspertëve do të kërkojë një shumicë të thjeshtë të vendeve të përfaqësuara në Bashkimin e Veçantë me të drejtë vote.

b) Vendimet në lidhje me adaptimin e ndryshimeve të klasifikimit do të kërkojnë një shumicë të katër të pestave të vendeve të përfaqësuara në Bashkimin e Veçantë dhe me të drejtë vote.

“Ndryshim” do të kuptojë çdo transferim të mallrave ose shërbimeve nga një klasë në tjetrën ose krijimin e një klase të re.

c) Rregullat e procedurës të përmendura në paragrafin (4) do të parashikojnë që, përveç rasteve të veçanta, ndryshimet në klasifikim do të adaptohen në fund të periudhave të specifikuara; kohëzgjatja e çdo periudhe do të përcaktohet nga Komiteti i ekspertëve.

8. Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

Neni 4

Njoftimet, hyrja në fuqi dhe botimi i ndryshimeve

1. Ndryshimet e vendosura nga Komiteti i ekspertëve dhe rekomandimet e Komitetit të ekspertëve do t’u njoftohen zyrtarisht kompetentëve të vendeve të Bashkimit të Veçantë nga Zyra Ndërkombëtare. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi gjashtë muaj pas datës së dërgimit të njoftimit. Çdo ndryshim tjetër do të hyjë në fuqi në një datë të përcaktuar nga Komiteti i ekspertëve në kohën kur ndryshimi adaptohet.

2. Zyra Ndërkombëtare do të inkorporojë në klasifikim ndryshimet të cilat kanë hyrë në fuqi. Lajmërimet e këtyre ndryshimeve do të botohen në periudhe siç mund ta caktojë Asambleja sipas nenit 5.

Neni 5

Asambleja e Bashkimit të Veçantë

1. a) Bashkimi i Veçantë do të ketë një Asamble të përbërë nga ato vende të cilat kanë ratifikuar ose pranuar këtë akt.

b) Qeveria e çdo vendi do të përfaqësohet nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegatë zëvendësues, këshilltarë dhe ekspertë.

c) Shpenzimet e çdo delegacioni do të përballohen nga qeveria që e ka emëruar atë.

2. a) Në varësi të dispozitave të neneve 3 dhe 4, Asambleja:

i) do të merret me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbajtjen dhe zhvillimin e Bashkimit të Veçantë dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

ii) do t’i japë direktiva Zyrës Ndërkombëtare lidhur me përgatitjen e konferencës së rishikimit, duke marrë në konsideratë çdo koment nga ato shtete të Bashkimit të Veçantë të cilat nuk e kanë ratifikuar ose pranuar këtë akt;

iii) do të rishikojë dhe aprovojë raportet dhe aktivitetet e Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës (këtej e tutje i quajtur si “Drejtori i Përgjithshëm”) në lidhje me Bashkimin e Veçantë dhe t’i japë atij të gjitha udhëzimet e nevojshme që kanë të bëjnë me çështje brenda kompetencave të Bashkimit të Veçantë;

iv) do të përcaktojë programin dhe adaptojë buxhetin dy-vjeçar të Bashkimit të Veçantë dhe aprovujë llogaritë e tij financiare;

v) do të adaptojë rregulloret financiare të Bashkimit të Veçantë;

vi) do të krijojë, përveç Komitetit të ekspertëve të përmendur në nenin 3, komitete të tjera ekspertësh dhe grupe pune, siç mund ta gjykojë të arsyeshme për të arritur objektivat e Bashkimit të Veçantë;

vii) do të përcaktojë cilat vende joanëtare të Bashkimit të Veçantë dhe cilat organizata ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare do të pranohen në mbledhjet e tij si vëzhgues;

viii) do të adaptojë ndryshimet e neneve 5 deri 8;

ix) do të marrë çdo veprim tjetër të përshtatshëm të përcaktuar, që të zhvillojnë objektivat e Bashkimit të Veçantë;

x) do të kryejë të tilla funksione të tjera që janë të përshtatshme sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) Në lidhje me çështjet të cilat gjithashtu janë në interes të bashkimeve të tjera të administruara nga Organizata, Asambleja do të marrë vendimet e saj pasi të ketë dëgjuar këshillën e Komitetit të Koordinimit të Organizatës.

3. a) Çdo vend anëtar i Asamblesë do të ketë një votë.

b) Gjysma e vendeve anëtare të Asamblesë do të përbëjë një shumicë.

c) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit (b), në qoftë se në çdo sesion, numri i vendeve të

përfaqësuar është më pak se gjysma, por e barabartë ose më shumë se një e treta e vendeve anëtare të Asamblesë, Asambleja mund të marrë vendime, përjashtojë vendimet që kanë të bëjnë me procedurën e votës; të gjitha këto vendime do të kenë efekt vetëm në rast se do të plotësohen kushtet që vijnë. Zyra Ndërkombëtare do t'ua komunikojë këto vendime vendeve anëtare të Asamblesë, të cilat nuk janë përfaqësuar dhe do t'i ftojë ato të shprehin me shkrim votën ose abstenimin e tyre brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e komunikimit. Në qoftë se, me përfundimin e kësaj periudhe, numri i shteteve që kanë shprehur për këtë votën ose abstenimin e tyre arrin numrin e shteteve që mungonin për arritjen e kuorumit në vetë sesionin, vendime të tilla do të kenë efekt, me kusht që në të njëjtën kohë shumica e kërkuar të sigurohet akoma.

d) Në varësi të dispozitave të nenit 8 (2), Asambleja do t'i marrë vendimet e saj me një shumicë të dy të tretave të votave të hedhura.

e) Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

f) Një delegat mund të përfaqësojë dhe votojë në emër vetëm të një shteti.

g) Vendet e Bashkimit të Veçantë joanëtare të asamblesë do të pranohen në mbledhjet e kësaj të fundit si vëzhguese.

4. a) Asambleja do të mbledhet një herë në çdo dy vite kalendarike në sesion të zakonshëm sipas thirrjes së Drejtorit të Përgjithshëm, dhe në mungesë të rrethanave përjashtimore, gjatë të njëjtës periudhe dhe në të njëjtin vend si Asambleja e Përgjithshme e Organizatës.

b) Asambleja do të mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm sipas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm, me kërkesën e një të katërtës së vendeve anëtarë të Asamblesë.

c) Axienda e çdo sesioni do të përgatitet nga Drejtori i Përgjithshëm.

5. Asambleja do të adaptojë rregullat e veta të procedurës.

Neni 6

Zyra Ndërkombëtare

1. a) Detyrat administrative që kanë të bëjnë me Bashkimin e Veçantë do të kryhen nga Zyra Ndërkombëtare.

b) Në veçanti, Zyra Ndërkombëtare do të përgatisë mbledhjet dhe të parashikojë Sekretariatin e Asamblesë, Komitetin e ekspertëve dhe nënkomitetet e tjera të ekspertëve dhe grupet e punës, siç mund të jenë krijuar nga Asambleja ose Komiteti i ekspertëve.

c) Drejtori i Përgjithshëm do të jetë shefi ekzekutiv i Bashkimit të Veçantë dhe do të përfaqësojë Bashkimin e Veçantë.

2. Drejtori i Përgjithshëm dhe çdo anëtar i stafit i caktuar prej tij do të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha mbledhjet e Asamblesë, Komitetit të ekspertëve, komiteteve të tjera të ekspertëve apo grupeve të punës, siç mund të jetë përcaktuar nga Asambleja ose Komiteti i ekspertëve. Drejtori i Përgjithshëm apo çdo anëtar i stafit i caktuar prej tij do të jenë ex officio sekretari i këtyre organizmave.

3. a) Zyra Ndërkombëtare, në përputhje me direktivat e Asamblesë, do të bëjë përgatitjet për konferencën e rishikimit të dispozitave të Marrëveshjes përveç neneve 5 deri 8.

b) Zyra Ndërkombëtare mund të konsultohet me organizata ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare në lidhje me përgatitjen për konferencën e rishikimit.

c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij do të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet e këtyre konferencave.

d) Zyra Ndërkombëtare do të kryejë çdo detyrë tjetër që do t'i caktohet.

Neni 7

Financat

1. a) Bashkimi i Veçantë do të ketë një buxhet.

b) Buxheti i Bashkimit të Veçantë do të përfshijë të ardhurat dhe shpenzimet që i takojnë Bashkimit të Veçantë, kontributet e buxhetit të shpenzimeve të përbashkëta të bashkimeve, dhe kur është e zbatueshme, shumën e vënë në dispozicion të buxhetit të konferencës së Organizatës.

c) Shpenzimet që nuk i atribuohen ekskluzivisht Bashkimit të Veçantë, por gjithashtu një ose më shumë bashkimeve të administruara nga Organizata do të konsiderohen si shpenzime të bashkimit.

Pjesa e Bashkimit të Veçantë në këto shpenzime të përbashkëta do të jetë në proporcion me interesin që Bashkimi i Veçantë ka në to.

2. Buxheti i Bashkimit të Veçantë do të përcaktohet në përputhje me kërkesat e koordinimit me buxhetet e bashkimeve të tjera të administruara nga Organizata.

3. Buxheti i Bashkimit të Veçantë do të financohet nga burimet e mëposhtme:

i) kontributet e vendeve të Bashkimit të Veçantë;

ii) tarifa dhe pagesa të përcaktuara për shërbime të bëra nga Zyra Ndërkombëtare në lidhje me Bashkimin e Veçantë.

iii) shitja apo pagesat e publikimeve të Zyrës Ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Bashkimin e Veçantë;

iv) dhurata, sende të trashëguara dhe subvencione;

v) renta, interesa dhe të ardhura të tjera të ndryshme.

4. a) Për qëllim të përcaktimit të kontributeve të veta të përmendura në paragrafin (3)(i), çdo vend i Bashkimit të Veçantë do t'i përkasë së njëjtës klasë siç i përket Bashkimit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe do të paguajë kontributet e veta vjetore mbi bazën e të njëjtit numër njësisish siç është caktuar për atë klasë në atë bashkim.

b) Kontributi vjetor i çdo vendi të Bashkimit të Veçantë do të jetë një sasi në të njëjtin proporcion me shumën totale të kontribuar në buxhetin e Bashkimit të Veçantë nga të gjitha vendet, aq sa numri i njësisive të saj është ndaj totalit të njësisive të të gjitha vendeve kontribuese.

c) Kontributet do të bëhen të pagueshme më një janar të çdo viti.

d) Çdo vend, i cili është mbrapa në pagesën e kontributit të tij, mund të mos ushtrojë të drejtën e votës në asnjë organ të Bashkimit të Veçantë, në qoftë se shuma e prapambetur e saj është e barabartë ose tejkalon shumën e kontributeve që i detyrohet asaj për dy vite të mëparshme të plota. Sidoqoftë, çdo organ i Bashkimit të Veçantë mund të lejojë një vend të tillë të ushtrojë të drejtën e tij të votës në atë organ në qoftë se, dhe për aq sa, është i bindur se vonesa në pagesë është për shkak të rrethanave përjashtimore dhe të pashmangshme.

e) Në qoftë se buxheti nuk është adaptuar përpara fillimit të periudhës së re financiare, buxheti do të jetë në të njëjtin nivel si buxheti i vitit të mëparshëm, siç parashikohet në rregulloret financiare.

5. Shuma e tarifave dhe pagesave të papaguara për shërbimet e bëra nga Zyra Ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Bashkimin e Veçantë do të përcaktohen dhe do t'i raportohen Asamblesë, nga Drejtori i Përgjithshëm.

6. a) Bashkimi i Veçantë do të ketë një fond kapital pune, i cili do të përbëhet nga një pagesë e vetme nga çdo vend i Bashkimit të Veçantë. Në qoftë se fondi bëhet i pamjaftueshëm, ai do të rritet.

b) Shuma e pagesës fillestare e çdo vendi të Bashkimit të Veçantë në këtë fond ose e pjesëmarrjes së tij në rritjen e saj do të jetë në proporcion të kontributeve të atij vendi për vitin në të cilin u krijua fondi apo u vendos rritja e tij.

c) Proporcioni dhe afatet e pagesës do të caktohen nga Asambleja me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm dhe pasi është dëgjuar edhe këshilla e Komitetit të Koordinimit të Organizatës.

7. a) Në marrëveshjen për selinë të përfunduar me vendin, në territorin e të cilit Organizata ka selinë e saj, do të parashikohet se, sa herë që fondi kapital i punës është i pamjaftueshëm, ky vend do të japë shuma hua. Shuma e këtyre huave dhe kushtet në të cilat ato janë dhënë do të jenë subjekt i një marrëveshjeje të veçantë, në çdo rast, ndërmjet vendit dhe Organizatës.

b) Vendi i përmendur në nënparagrafin (a) dhe Organizata do të kenë secili të drejtën për të denoncuar detyrimin për të dhënë hua, sipas njoftimit me shkrim. Denoncimi do të ketë efekt tre vjet pas mbarimit të vitit në të cilin është bërë njoftimi.

8. Auditimi i llogarive do të kryhet nga një ose shumë vende të Bashkimit të Veçantë ose nga auditorë të jashtëm, siç parashikohet në rregulloret financiare. Ata do të caktohen, me marrëveshjen e tyre, nga Asambleja.

Neni 8

Ndryshimi i neneve 5 deri 8

1. Propozimet për ndryshimin e nenit 5, 6, 7 dhe ky nen, mund të fillohen nga çdo vend anëtar i Asamblesë ose nga Drejtori i Përgjithshëm. Këto propozime do t'u komunikohen vendeve anëtare të Asamblesë nga Drejtori i Përgjithshëm të paktën gjashtë muaj përpara konsiderimit të tyre nga

asambleja.

2. Ndryshimet e neneve të përmendura në paragrafin (1) do të adaptohen nga Asambleja. Adaptimi i tyre do të kërkojë tre të katërtën e votave të hedhura, me kusht që çdo ndryshim i nenit 5, dhe i këtij paragrafi, do të kërkojnë katër të pestat e votave të hedhura.

3. Çdo ndryshim i nenit të përmendur në paragrafin (1) do të hyjë në fuqi një muaj pas njoftimit me shkrim të pranimi, të kryer në përputhje me proceset e tyre përkatëse konstitucionale, pasi është pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm nga tre të katërtat e vendeve anëtarë të Asamblesë në kohën kur ajo adaptoi ndryshimin. Çdo ndryshim i këtij neni i pranuar në këtë mënyrë do t'i detyrojë të gjitha vendet që janë anëtarë të Asamblesë në kohën kur ndryshimi hyn në fuqi, ose të cilat bëhen anëtarë të saj në një datë të mëvonshme, me kusht që të sigurojë që çdo ndryshim që rrit detyrimet financiare të vendeve të Bashkimit të Veçantë detyron vetëm ato vende të cilat kanë njoftuar pranimin e tyre për këtë ndryshim.

Neni 9

Ratifikimi dhe pranimi; hyrja në fuqi

1. Çdo vend i Bashkimit të Veçantë, i cili ka nënshkruar këtë akt mund ta ratifikojë atë dhe, në rast se nuk e nënshkruan, mund ta pranojë atë.

2. Çdo vend jashtë Bashkimit të Veçantë, i cili është palë e Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale mund ta pranojë këtë akt dhe të bëhet kështu një vend i Bashkimit të Veçantë.

3. Instrumentet e ratifikimit dhe pranimi do të depozitohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

4. a) Ky akt do të hyjë në fuqi tre muaj pasi të jenë plotësuar të dy kushtet që vijojnë:

i) gjashtë ose më shumë vende kanë depozituar instrumentet e ratifikimit ose të pranimi;

ii) të paktën tre nga këto vende janë vende të cilat, në datën kur ky akt hapet për nënshkrim, janë vende të Bashkimit të Veçantë.

b) Hyrja në fuqi e përmendur në nënparagrafin (a) do të zbatohet ndaj atyre vendeve të cilat, të paktën tre muaj hyrjes në fuqi, kanë depozituar instrumentet e ratifikimit ose pranimi.

c) Në lidhje me çdo vend që nuk mbulohet nga nënparagrafi (a), ky akt do të hyjë në fuqi tre muaj mbas datës në të cilën ratifikimi ose pranimi i tij ishte njoftuar nga Drejtori i Përgjithshëm, përveç se kur një datë e mëvonshme është treguar në instrumentin e ratifikimit ose të pranimi. Në rastin e fundit, ky akt do të hyjë në fuqi në lidhje me atë vend në datën e treguar si më sipër.

1. Ratifikimi ose pranimi do të shkaktojë automatikisht pranimin e të gjitha klauzolave dhe pranimin e të gjitha avantazheve të këtij akti.

2. Mbas hyrjes në fuqi të këtij akti, asnjë vend nuk mund të ratifikojë ose pranojë një akt të mëparshëm të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje do të ketë të njëjtën kohëzgjatje si Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

Neni 11

Rishikimi

1. Kjo Marrëveshje mund të rishikohet herë pas here nga një konferencë e vendeve të Bashkimit të Veçantë.

2. Thirrja e çdo conference rishikimi do të vendoset nga Asambleja.

3. Nenet 5 deri 8 mund të ndryshohen ose nga një konferencë rishikimi ose sipas nenit 8.

Neni 12

Denoncimi

1. Çdo vend mund ta denoncojë këtë akt nëpërmjet njoftimit drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm.

Të tilla denoncime do të përbëjnë gjithashtu denoncime të aktit të mëparshëm ose akteve të kësaj Marrëveshjeje. Vendi, i cili e denoncon këtë akt mund ta ketë ratifikuar ose pranuar, dhe do të prekë vetëm vendin që e bën atë, duke bërë që Marrëveshja të qëndrojë në fuqi dhe me efekt të plotë në lidhje me vendet e tjera të Bashkimit të Veçantë.

2. Denoncimi do të ketë efekt një vit mbas datës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka marrë njoftimin.

3. E drejta e denoncimit e parashikuar në këtë nen nuk do të ushtrohet nga asnjë vend përpara përfundimit të pesë vjetëve nga data në të cilën ai bëhet vend i Bashkimit të Veçantë.

Neni 13

Referimi i nenit 24 i Konventës së Parisit

Dispozitat e nenit 24 të aktit të Stokholmit të 1967 të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale do të zbatohet ndaj kësaj Marrëveshjeje me kusht që, në qoftë se këto dispozita janë ndryshuar në të ardhmen, ndryshimi i fundit do të zbatohet ndaj kësaj Marrëveshjeje në lidhje me ato vende të Bashkimit të Veçantë, të cilat janë kufizuar nga këto ndryshime.

Neni 14

Nënshkrimi; gjuhët; funksionet depozitare; njoftimet

1. a) Ky akt do të nënshkruhet në një origjinal të vetëm në gjuhët angleze dhe franceze, duke qenë të dy tekset në mënyrë të barabartë autentike dhe do të depozitohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

b) Tekstet zyrtare të këtij akti do të vendosen nga Drejtori i Përgjithshëm, mbas konsultimeve me qeveritë e interesuara dhe brenda dy muajve nga data e nënshkrimit të këtij akti, në dy gjuhët e tjera, rusisht dhe spanjisht, në të cilat, së bashku me gjuhët e përmendura në nënparagrafin (a), janë nënshkruar tekstet autentike të Konventës për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelktuale.

c) Tekstet zyrtare të këtij akti do të përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm, mbas konsultimeve me qeveritë e interesuara, në gjuhët arabe, gjermane, italiane dhe portugeze, si dhe në ato gjuhë të tjera që mund të vendosë Asambleja.

2. Ky akt do të qëndrojë i hapur për nënshkrim deri më 31 dhjetor 1977.

3. a) Drejtori i Përgjithshëm do të transmetojë dy kopje, të vërtetuara prej tij, të ndonjë ndryshimi të tekstit të këtij akti, qeverive të të gjitha vendeve të Bashkimit të Veçantë dhe, me kërkesë, të qeverisë së ndonjë vendi tjetër.

b) Drejtori i Përgjithshëm do të transmetojë dy kopje, të vërtetuara prej tij, të çdo ndryshimi të këtij akti qeverive të të gjitha vendeve të Bashkimit të Veçantë dhe me kërkesë, të qeverisë së çdo vendi tjetër.

4. Drejtori i Përgjithshëm do të regjistrojë këtë akt pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

5. Drejtori i Përgjithshëm do të njoftojë qeveritë e të gjitha vendeve palë të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale për:

i) nënshkrimet sipas paragrafit (1);

ii) depozitimet e instrumenteve të ratifikimit dhe pranimi sipas nenit 9(3);

iii) datën e hyrjes në fuqi të këtij akti sipas nenit 9(4)(a);

iv) pranimin e ndryshimeve të këtij akti sipas nenit 8(3);

v) datat në cilat këto ndryshime hyjnë në fuqi;

vi) denoncimet e pranura sipas nenit 12.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 25.4.2003

Doli nga shtypi më 28.4.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë